

Botuesi dhe shkrimtari Xhevair Lleshi, kur ishte skenarist në teatrin e Beratit, sëbashku me regjisorin Sheri Mita, takohen me poetin Fatos Arapi. Ishte mëngjesi i 13 prillit 1990. Duke vizituar kalanë e Beratit, z. Lleshi e ka regjistruar këtë bisedë interesante e cila që të nesërmen u «zbardh», mori formën e shkruar. Dhe pa ndonjë arsye themelore ky kujtim i bukur mbeti pa u botuar. Tani që poeti i madh Fatos Arapi nuk jeton më, kjo bisedë bëhet më e dashur dhe më e çmuar.

Fatos Arapi

Poezia ime është e ngjeshur në mendim dhe imazh plot ngjyra...



Intervistoi Xhevair Lleshi

SI LINDI POEZIA "SAHARAJA" E VILSON BLOSHMIT? nga Yzedin Hima

(fq. 5)

Poezia "Saharaja" (1974) është poezia më e arrirë e Vilson Blloshmit. Ajo është një kryevepër e kohës kur u shkrua. "Saharaja" është një tekst i hapur poetik. Lexuesit e gjejnë këtë tekst si një krijim ambigue që lejon këndvështrime e interpretime të ndryshme dhe të shumta.



Një vepër e rrallë që ndriçon fort thelbin e letërsisë dhe poetikat e saj

"POSTMODERNIZMI" I FLORESHA DADOS

nga Mira Meksi

(fq. 6)

Të udhëtosh labirinteve të teorisë së letërsisë, labirinteve të studimit shkencor të letërsisë, që e trajton këtë të fundit si një fenomen kulturor, por jo vetëm, nuk është punë e lehtë. Aq më shumë për një krijuese letrare, në rastin tim, që shkrimësisë, letërsisë pra, i qaset më e shumta intuitivisht.

Dramat *Lojë mbasdreke* dhe *Kandilja e argjandit*, të Martin Camajt

DRAMATIKA E NATYRËS SURREALE

(fq. 12)

nga Behar Gjoka

Pjesë e vler të krijimtarisë letrare, të gjerë dhe përplot larmi të Martin Camajt është edhe dramaturgjia, madje ajo shënon edhe njërin prej shenjave letrare më impresionuese, gati e harruar prej historiografisë...

Mbi librin e Sadik Bejkos

NJË KAMBANË QË KUMBON NË HESHTJE

Nga Pirro Loli

(fq. 14)

Kënga e Solomonit është këngë biblike. Është Kënga e këngëve, ose kënga e dashurisë. Ka mijëra vjet që ecën drejt nesh, drejt çdo çifti të dashuruar. Dy trupa mish e shpirt, dy buzë të kuqa që puthen, e brishtë me aromë e verëkuqe, romantike e qiellore, por dhe tokësore me luftën për të jetuar e me dramat zakonshme të njeriut.

NË KOHËN E HOMERIT, NJERËZIT NUK E DALLONIN NGJYRËN BLU

nga Alex Bellos

(fq. 18)



BIBLIOTEKË

— **FAIK BALLANCA**

(fq. 8)

Kënga e Fundit e Marko Boçarit

— **JEFFREY ARCHER**

(fq. 9)

Një orë udhëtim

— **NEVIANA SHEHI**

(fq. 10)

Geisha e fjalës së bukur

— **THANAS DINO**

(fq. 11)

Jam fik deti

(Ese e shkurtër mbi Migel de Servantes [Miguel de Cervantes Saavedra, Alcalá de Henares, 5, 29 shtator 1557 - Madrid, 22 prill 1616: ushtar, romancier, poet dhe dramaturg spanjoll] dhe *Don Kishotin e Mançës*.)

**VICTOR AQUILES
JIMÉNEZ**

Një qasje e re

(fq. 16)

Botuesi dhe shkrimtari Xhevair Lleshi, kur ishte skenarist në teatrin e Beratit, sëbashku me regjisorin Sheri Mita, takohen me poetin Fatos Arapi. Ishte mëngjesi i 13 prillit 1990. Duke vizituar kalanë e Beratit, z. Lleshi e ka regjistruar këtë bisedë interesante e cila që të nesërmen u «zbardh», mori formën e shkruar. Dhe pa ndonjë arsye themelore ky kujtim i bukur mbeti pa u botuar. Tani që poeti i madh Fatos Arapi nuk jeton më, kjo bisedë bëhet më e dashur dhe më e çmuar.

Fatos Arapi

POEZIA IME ËSHTË E NGJESHUR NË MENDIM DHE IMAZH PLOT NGJYRA...

Intervistoi Xhevair Lleshi



lidhen gjëkund. E them në një kuptim simbolik. Dhe letërsia kthehet në pandehmë. Poema «*I përkasim komunizmit*». *Sindroma e pages bëhet besim me vlerë dhe iluzion i bukur.* Por ka për të munguar dega e dafinës... Iluzioni apo optimizmi. Një punë e bukur nuk del nga iluzionet, por nga energjia optimiste...

Xhevair Lleshi - Profesor, a je i gatshëm të ngjitemi në Kala?

Fatos Arapi – Me ty jam gati të shkoj deri në Kala, po me një kusht: Ta gjezdisim cep më cep...

XH. LL. - Bukur. Tjetër, ç'kërkon prej meje?

F. A. - Kaq mjafton, por do të doja ta kisha një ciceron të madh, sidoqoftë Vehxhi Buharaja, fjala vjen, është i gatshëm, vjen dot? Jo? Po Todi Sotira... E kam dëgjuar si ciceron në Muzeun Historik te Sarajet e Pashait... Perlë... Vjen?

XH. LL. - Për fat të keq... Por një dytës jam edhe unë. Kam qenë nxënës i tij në tre vitet e shkollës së mesme. S'kemi lënë gur pa prekur në Berat me të... Shkollë e madhe...!

F. A. - Ashtu po. E meritojmë të dy. Todi, besoj do të ketë «thyer këmbën»?... Them gjithnjë çfarë

i mungon Beratit... Deti i mungon. Në përfundim deti dhe ullishtat do të flakëronin. Do të krijohet bluja më e bukur në botë. Dhe ne do të shikonim në një nge poetike këtu në Kalanë e madhe dhe do të kapnim për mënje njëri-tjetrin. Do të pyesnim edhe Kalanë, edhe detin...

XH. LL. - Ç'është Vlora për të shkruarit, mjeshtër? Do ta jepte edhe Berati këtë mundësi?

F. A. - Tryeza e shkrimit është një edhe në Vlorë, edhe në Berat. Në Vlorë: Deti, Mali dhe Historia. Në Berat: Mali, Historia dhe Lumi. Historia të ndjek nëpër shkarëzime. Ajo është paralajmëruesja. Ia ke parë sytë? Vlora ka një egërsi magjike. Berati ka një butësi biblike...

XH. LL. - Ju jepni ekonomi politike...

F. A. - Po. Letërsia dhe ekonomia politike nuk

XH. LL. - A është e rrezikshme letërsia, profesor?

F. A. - Shpesh pendohemi për atë që shkruajmë, pastaj të nesërmen bëjmë të njëjtën gjë. Letërsia s'ka nevojë të jesh nervoz, i ashpër apo cinik, por joshës. Migjen. Ose Vapcarov, meqë kam studiuar në Bullgari. Kam mësuar shumë prej tij në përkthim e sipër: ritmi, kadenca, muzikaliteti, ngjyra, pastaj ngrohtësinë, intimitetin, elegancën, lajtmotivin... Pa fund... Një sinqeritet i nivelit më të hijshëm. Po edhe entuziazëm magjik. Që e mban në shpirt si të fshehtë Historia dhe Mali. Deti e shpërthen. Lumi e çon në det... Po edhe figurat e guximshme, ndjeshmëria e lartë, po edhe fryma popullore. A të ka thënë ndonjëherë Vexhi Buharaja këtë që letërsia është e rrezikshme... S'besoj!...

XH. LL. - Sinqeriteti dhe e vërteta! Kjo ka qenë magjia e Vexhi Buharasë... Po për ju?



Nga e djathta, Naum Prifti, Vito Koçi, Dritëro Agolli, Kin Dushi, Fatos Arapi, Anastas Kondo, përpara klubit të Lidhjes së Shkrimtarëve, 1964.

F. A. - Singeriteti në të shkruar është trimëri, fat, frutdhënës - ndonëse shpesh i hidhur, tharm i madh artistik, tundim, sakrificë, shpirt, abstragim... Poezia dhe singeriteti (ky është baza e së vërtetës) japin meditim, theks filozofik, zhdërvjelltësi...

XH.LL. - Letërsia e mban shkrimtarin ndonjëherë «në hije»?

F. A. - Shkrimtarit dhe trillimit letrar realiteti i kërkon ndihmë. Shkrimtarët i marrin shembujt nga vetvetja dhe nga shtëpia e tyre. Në hije? Jo kurrë! Vetëm kur realiteti ta ftoj entuziazmin... Tema e vërtetë letrare është ajo që përjeton përditë si individ. Edhe në peizazhet e mia industriale, ka shumë singeritet intim po edhe shije estetike tradicionale, ka ndjeshmëri migjeniane dhe të Vapcarovit... Poezi e ngjeshur në mendim dhe imazh plot ngjyra, por nuk duhet të mungojë kurrë eleganca. Nuk mund të shkruash poezi fine duke mbajtur këpucë të llangosura me baltë. Po, baltën mbaje në duar, jepi formë, thadroje në poezi...

XH.LL. - A e sakrifikojnë singeritetin poetët?

F. A. - Poetët shqiptarë e ke fjalën? Po? Nuk është këtu thelbi i singeritetit, sepse poezia fle dhe rritet tek poeti. Dhe ka një delikatesë që të trondit gjatë gjithë kohës. Por nganjëherë të bën delirant... E çmoj idealizmin e klasikëve tanë, edhe tek Lasgushi, por singeriteti duhet të na shtyjë drejt një profecie të pamundur, i paracaktuar nga fati, me instinkt dhe kod të fshehtë. A ka lezet poeti me pamje të nënshtruar? Kurrë! Ato çaste duhet ta zësh me dru! Por jo, vetëm temperament dhe me temperaturë të lartë, veç jo në pikën e shkrirjes. Ajo s'ka kuptim... Sido që poeti rri në buzë të greminës, i pëlqen kjo. Sidomos kur gremina është buzë detit dhe e rreh stuhia, pastaj... flladi.

XH.LL. - Besoni se kumtet poetike vijnë pa prituri?

F.A. - Unë besoj. Thuhet në shkrimet e shenjta. Vjen si pandehmë e një fuqie të mbinatyrshe që ndryshe është tej-nënvetëdija, që ka të bëjë me Unin... Këtë e thoshte dhe im vëlla, Vllasi, që nuk ka qenë poet, por ka luftuar me pushkë në dorë për liri. Nganjëherë këtë e trondit edhe guximi i skajshëm. Siç ndodh që profecinë e poetit e shkatërron zhgënjimi...

XH.LL. - Poezitë e dashurisë...?

F.A. - Në çdo kohë shkruhen poezi dashurie. Janë poezitë e mëkatit... Poezia nganjëherë fiton peshë nga inicialet e femrave... Çfarë magjie e mrekullueshme! Me to krahasohen poezitë e detit me metaforën e ndritshme, që shpesh e ka prejardhjen tek polifonia labe, te *Kurelashi* (Kurveleshi!) i famshëm, diçka e papërsëritshme! Aty vjen hijerëndë Historia dhe Mali, që e bëjnë *Trion* me Detin... Poezia e dashurisë është kokëkrisur...


XH.LL. - Ç'do të thotë për një poet të jetë një burrë i bukur dhe me sytë blu si deti, madje edhe me një hije të shkruar...?

F.A. - Domosdo këta sy të poetit duhet të kenë «tehe të mprehtë çeliku»! Parullë e kohës... Por edhe një trëndafila të kujtdo stine, pak fshehtësi, sekret dhe në sfond një polifoni që nuk mbaron kurrë... T'i largohesh dhimbjes me mjete stilistike...

XH.LL. - Ju besoni se Kalaja e Beratit është një histori e bukur dashurie?

F.A. - Po, patjetër. I ka gjithë parametrat e duhur për të qenë historia e bukur dashurie: teksti i shkruar, metafora e ndërtimit, subjekti, gjuha, stili, ngashënjimi. Por Kalaja e Beratit para së gjithash është *Histori* dhe pastaj meriton të jetë edhe *histori e bukur dashurie*. E gjithë *historia jonë*

është e tillë dhe mjeshtrit kuptohet që e kthejnë në letërsi të vërtetë. Ja, mua për shembull, më duket sikur tërheq zvarrë detin. Detin, dashurinë dhe pikëllimin...



XH.LL. - A është poezia jote një guaskë e kaltër sirene dhe nëse po, pse pikërisht kështu?

F.A. - Nuk më pëlqen të jetë kështu. Në vetvete si figurë po, por kjo nuk ka fare vijë ndarëse. Mua do t'më pëlqente të tundoja Odisenë në thellësitat blu të Jonit, të zgjohesha krejt papritur me Kadarenë dhe Xhojsin në barkën e Noes dhe me Borhesin dhe Pasternakun apo Ivan Buninin të këndoja se «atdheu është dhimbje»... Dhe të mos bëje dot asgjë. Si një mallkim. Si sakrificë. Si grimca rëre pa kujtesë që dikur siç besohet dhe shpresohet do kthehen në margaritarë...

XH.LL. - A mund të kthehemi te Kalaja e Beratit?

F.A. - Këtu jemi. Këtu të paktën nuk bie në dëshpërim. Sepse edhe në këtë Kala unë s'do të bëja tjetër veç një gjë të dhimbshme e të bukur: të shkruaja... Dhe kjo duket si frymë kokëkrisjeje dhe e tillë është tek e fundit. Por këtu ke shkëmbin por të mungon deti. Lumi? Sido, nuk e zëvendëson dot detin. Veç nganjëherë kur e bën pakujdesia. Në ato raste ndodh sepse ka dashur poezia. Poezia e fatit që rebelohet shpesh me zë plot ajër e stuhi dhe gjithnjë duke prituri... ekstazat e zjarrit! Nëpër këto ekstaza e shoh Kalanë e madhërishtme të Beratit, edhe atë ditë kur ma shpjegonte Todi Sotira, edhe sot kur më pyet ti...

XH.LL. - A i di përmendësh vargjet e tu?

F.A. - Dy tre, jo më shumë. Ia them me të qeshur ndonjë miku a mikeshe...

XH.LL. - Do t'i recitonit vargjet në skenë?

F.A. - Një poet është kurdoherë në skenë. Skena është më e rëndësishme se ne. Kjo kohë është e skenës. Edhe kjo që po vjen... Dhe unë do ta ngrija zërin në krijim e sipër dhe do të përpija ekstaza dhe do të shuaja zjarret shfaruese të kalave tona ku digjen ende shpirtra njerëzorë, zjarre mendimi, zjarre humbjeje. Pra, në skenë jemi, në skenën që digjet...

XH.LL. - Po nga podiumet a përfiton poezia?

F.A. - Në kuptimin e përfitimit nga podiumet unë gjithmonë kam humbur. Në podium rrinë të zgjedhurit, kurse poezia ulet mbi bar këmbëkryq dhe aty ndjehet vetëm por mirë. I shkon me fjetet e barit, aty s'ka gjendje depresioni për t'u shqetësuar, aty nuk bëhesh nervoz, gati për të shpërthyer... Gjëja më e bukur është se poezia s'ka hakmarrje por trishtim e pikëllim të qetë, i zjarritur përbrenda si deti në bunacë...

XH. LL. - A mendoni se po vijnë politikanët e fronit prej gjaku??

F. A. - Shpirti im ka uri të përjetshme. Sapo ka filluar dhe ka për të vazhduar gjatë, shumë gjatë. Vendi ynë ka qenë pjesë e perandorive. Larg sherreve te koka. Ai ka bërë llogari për ditën. Aq sa zgjat jeta. Se jeta është çasti. Përfytyrimi për më tej zgjat veç një çast, aq sa edhe mallkimi... Tani që ne flasim po hipim në skenën e politikanëve në frona prej gjaku, ku letërsia (edhe poezia) frymëzohen por gjithnjë dalin të humbura dhe jashtë beteje...

XH. LL. - Çfarë, për shembull do t'i thoshit epokës së re që po vjen?

F. A. - Të gjejë habitatin e saj, se ai s'e gjen kurrë kohën dhe vendin që i takon, s'është as në kohën dhe as në vendin e duhur. Bën kapërcime të hatashme, dhe ne, meqë jemi të vegjël mbetemi



FATOS ARAPI

nën kapërcyell, fare të tepërt, si pa kohë. Ose na mungon koha, nuk na mjafton vendi dhe njerëzit duan të shohin diku, ca më tej, duan të harrojnë dhe problemi do të jetë harresa. Dhe poetët sigurisht bëhen gati të shkojnë kuturu në një takim dashurie si për të bërë gati fronin e rinisë me frymë marrëzie dhe tërë abstragim me aromë deti...

XH. LL. - Po rinia, ju thatë se është edhe ajo nën kapërcyell?

F. A. - Aty është. Por ajo vështrohet diku larg dhe e gjen rrugën më lehtë. Rinia bart poezi të mahnitshme: gjetje të pashembullta, ritëm dhe shumë shpirt, por nuk mund t'i besohet fronti i shtetit se pastaj do t'i kemi bashkëjetuese marrëzitë. A duam ne të shpejtojmë apokalipsin?

Por kjo ndodh kur rinia merr në krahë poezinë. Ne e dimë se edhe kur bëhen bashkë mes tyre futet grindja, që hiqet zvarrë dhe u bëhet pengesë... Ah, poezia!

XH. LL. - Do ta donit shpirtin tuaj si eremit?

F. A. - Do ta doja. Sepse eremitët e duan dhe merren me fjalën. Dhe nuk bëjnë një punë dosido, as sa për t'ia hedhur. Letërsinë e bëjnë eremitët. Ata prodhojnë karaktere që hipin dhe zbresin nga skenat. Që nga koha e shpellave deri sot e kësaj dite.

XH. LL. - Do ta marrim me vete kohën që po lëmë pas?

F. A. - Do t'i marrim vetëm dosjet. Dhe mos harroni se ato do t'i ruajmë fort. Sepse ato prodhojnë kaos. Ne e duam kaosin. Rrëmujën... A jemi në kapërcyell. Dhe kam frikë se do rrimë shumë gjatë aty...

XH. LL. - Atëherë po jua përsëris pyetjen: Keni vendosur të mos dilni jashtë këtij kapërcyelli?

F. A. - Jo, ende jo. Më ndjek një plak i urtë ngado kthehem. Nuk dua ta takoj. Besoj se edhe këtu në Kalanë e Beratit pas do ta kemi. Më thotë se është ndarë nga Poezia dhe s'di ku të qëndrojë, s'di ku të prehet. Ai qahet por nuk dëgjon. Po duket se e ka gjetur damarin, sepse shpesh e më shpesh e gjej buzë shkëmbinjeve mbi det... Edhe unë atje shkoj... S'ka si hapësira e detit! Edhe kur je nën kapërcyell. Pastaj... edhe unë po plakem...

XH. LL. - Po bien kambanat, profesor, i dëgjon?

F. A. - Këtu në Kala është vendi i tyre: dyzet kisha dhe tridhjetenëntë shtëpi, më thoshte Todi Sotira. Çfarë presim? Ta festojmë. Erdhi dhe kjo kohë. E papritura e madhe... Por s'di kush do t'u bjerë kambanave. Se ato duan veshë që t'i dëgjojnë... Përndryshe vjen zilia dhe ajo nga kotësia kam frikë se do thyejë kokën... A bëjmë dot ne pa zili?... Fajin e kanë poetët ndaj do të mbeten përjetësisht të vetmuar.

Kala e Beratit, 13 prill 1990



Fatos Arapi, Skifter Këlliçi dhe Agim Cerga gjatë një mbledhje. Tiranë, 1972

SI LINDI POEZIA "SAHARAJA" E VILSON BLOSHMIT?

nga Yzedin Hima

Poezia "Saharaja" (1974) është poezia më e arrirë e Vilson Blloshmit. Ajo është një kryevepër e kohës kur u shkrua. "Saharaja" është një tekst i hapur poetik. Lexuesit e gjejnë këtë tekst si një krijim ambigüe që lejon këndvështrime e interpretime të ndryshme dhe të shumta. Pikërisht kjo begati kuptueshmërie e tekstit poetik u shfrytëzua nga ekspertët letrarë të policisë së fshehtë, të cilët e ngurtësuan, e hermetizuan tekstin, zbuluan shenja e kode të cilat, jo se nuk ekzistonin në këtë tekst, por i veçuan mekanikisht ato për të bërë dekodifikimn e tekstit vetëm në një plan, në planin ideologjik, duke e varfëruar nga shenjat e kodet e begata të domethënieve filozofike e estetike dhe në analizë të fundit e fundosën autorin e poezisë. Poezia "Saharaja" është shkruar në njëmbëdhjetë rrokësh, varg i metrikës italiane, varg me të cilin Danteja shkroi "Ferrin". Strofot janë katërshe me rimë të kryqëzuar (abab). Figurat kryesore janë simboli, metafora, aliteracioni, anafora, analogjia etj. Që në titull kemi një symbol - Saharaja, shkretëtirë që mund të zhvendoset në çdo cep të globit, shkretëtirë që sulmon, rrethon individin me shkretinë e saj, shkretëtirë që mbërthen shtetin, logjikën e tij, memorjen e tij, shkretëtirë që shkreteton kujtesën e një kombi, e një populli, shkretëtirë që përfshin shpirta njerëzorë duke i kthyer ato në shkëmb, rërë e gur. Simboli është një figurë letrare enigmatike dhe kurrë e deshifruar gjer në fund, ndaj mund të renditen edhe shumë e shumë kuptime të tjera.

Fjala Saharaja kthehet në shenjë në këtë tekst, për të shenjuar dukuri, objekte që kanë humbur identitetin dhe janë kthyer në shkreti, fenomene që i sulen gjithçkaje jetësore për ta shkretuar. Fjala Saharaja është shenjë që dehumanizon mjedisin, dehumanizon turmën dhe sulmon e përpiket të ç'njerëzgjë individin. Batica e saj është e pandalshme dhe e pashpirt. Metaforat: *s'sheh ëndërra, s'sheh as drurë, Saharaja s'di të ëndërrojë, Ajo bluan gurë me mënd' e saja, Saharaja s'ka këngë të këndojë, Saharaja s'ka as lotë të qajë* japin dimesionin e dehumanizmit të saj.

Në pesë strofat e para të poezisë "Saharaja" autori bën portretin e shkretëtirës. Në katër strofat e tjera të tekstit Saharaja shfaqet në baticën e saj drejt hapësirave të tjera. Ne pesë strofat e para mungesa është shenjë që shenjon përmasat e shkretëtisë. Me pjesëzat *s' e nuk* ndërtohen këto strofa: *s'sheh ëndërra, s'sheh as drurë, s'di të ëndërrojë, s'ka këngë, s'ka as lotë, nuk ka miq, nuk ka shokë, nuk ka bijë, as bir, s'shkon mirë, s'i pëlqen, Fjalë e dashuri e njerëz s'ka, Perç' e saj e zezë s'ka ç'të mbulojë.*¹ Edhe simbolet e tjera në këtë tekst si ëndrra (e ardhmja më e mirë, më dinjitoze, më njerëzore), drurë (gjelbërim, jetë), këngë (gëzim, hare), lot (ndjeshmëri, dhimbje, mëshirë), janë në funksionin e portretizimit të së keqes (Sahasë). Nata, si simbol i fshehjes, i qetësisë dhe i prehjes refuzon të mbulojë këtë shëmti e shkreti: *Saharaja është një një copë tokë, / Thonë se dhe me natën s'shkon mirë. / Natës s'i pëlqen Saharaja, / S'i pëlqen të ketë veç gurë për shtrojë; / Fjalë e dashuri e njerëz s'ka; / Perç' e saj e zezë s'ka ç'të mbulojë.*² /

Në pjesë e dytë, siç përmendëm edhe më lart, në tekst e takojmë shkretëtirën jo thjesht si portret, por si objekt (madje edhe si subjekt) në lëvizje, jo në zbaticë, por në baticë. Madje metaforat: *e mban vesh e qesh* (Saharaja shënimi im, Y. H.), *fillon të gëzojë*, në kundërshtim me dehumanizmin e Saharasë në pesë strofat e para, shprehin personifikimin e saj me njeriun, por me njeriun e çnjerëzuar, që thirret në ndihmë për të ndëshkuar: *Prandaj kur urrejtja e fortë e nxehur / Mbi*

dikë mallon e shfryn e shan, / Që nga skuta del kujtimi i dehur / Dhe thërret menjëherë Saharanë.

Saharaja si shenjë shenjon në këtë pjesë të tekstit dhunën, represionin, instrumentat e tyre. Teksti është ndërtuar me mjete që takohen në stilistikën estetike të teksteve poetikë të simbolistëve si pyll simbolesh, alegori, analogji dhe muzikalitet të vargut dhe imazh që realizohen nga aliteracioni, rima, enumeracioni etj. Aliteracioni: *Saharaja, larg është Saharaja*, ku bashkëtingëlloretja e shurdhër *r* përsëritet në çdo varg dhe të jep përshtypjen e ecjes në rërë. Në vargun: *Shkretëtirës shket e shkrepët* kemi bashkëtingëlloret *t, r, sh* dhe *k, r, t* të cilat japin lëvizjen tinëzare të baticës së shkretëtirës. Vargu është marrë nga strofa e dytë e pjesë së dytë të tekstit poetik. Të njëjtin aliteracion e gjejmë edhe te vargu i strofës së fundit në pjesën e dytë të poezisë: *Shkretëtirë e shkretë mbetet shkret*, që mbyll poezinë, ku kemi bashtingëlloret *sh, k, r, t* të përsëritura respektivisht nga tre herë dhe bashkëtingëlloretja *t* gjashtë herë, duke të lënë mbresën se batica vjen e vjen pa ndalim, madje është pranë autorit. Muzikaliteti i vargut përftohet edhe nga përdorimi i zanoreve si: *Saharaja, larg është Saharaja*, ku kemi nëntë zanore *a* (dukuri e rrallë) dhe dy *e*. Vargu pa bashkëtingëlloret ka një grafemë të tillë: a a a a e e a a a . Jehona e

zanoreve të jep imazhin e një hapësire shkretie pa anë e pa fund.

Bien në sy edhe përdorimi i figurave të ndërtimit (sintaksës poetike) si anafora: *Saharaja nuk ka miq e shokë, / Saharaja nuk ka bijë, as bir. / Saharaja është një copë tokë, Thonë se dhe me natën s'shkon mirë.* / Në fillim të çdo vargu përsëritet fjala Saharaja.

Si lindi poezia Saharaja? Nuk kemi shënime për këtë tekst nga vetë autori, të paktën nuk ka të botuara, ose nuk janë gjendur ende. Sidoqoftë në Veprën I të Vilson Blloshmit gjejmë edhe disa përgjigje të tij para hetuesit për të cilat kemi folur edhe më lart. Në një pjesë të përgjigjes së Vilson Blloshmit thuhet: *"Në vitin 1973 kam bërë një poezi tjetër mbi veten time. Atëherë kam qënë në gjendje ankthi... Në atë kohë unë punoja druvar në Stravaj, isha i lodhur, i mërëzitur, më dhimbte stomaku. Siç e kam thënë, unë kam qënë pesimist dhe e kam pasur në natyrë trishtimin."* Poezia është shkruar pikërisht në harkun kohor 25.10.1973 / 25.10. 1974, kohë për të cilën flet Vilson Blloshmi. Ai flet për një vend të quajtur Stravaj, ku rropatej si druvar. Gjendjen shpirtërore dhe fizike ai përshkruan si të rëndë. Stravaj, ky toponim ku qe dënuar të punonte poeti përbëhet nga dy silaba: stra dhe vaj. Rrokja e dytë *vaj* (kuje) përqaset me gjendjen e vajtueshme të poetit, i lënë mënjane, i veçuar, i dënuar të punojë në punë të rënda, ndërsa rrokja e parë *stra* kur shqiptohet i përngjet çjerrjes së një korbi: *stra-stra-stra!* Mendoj se në bazë të asocacioneve poeti V. Blloshmi ka krijuar në mendje shkretëtirën: korbi (stra, stra, stra) + njeriu gjysëm i gjallë e gjysëm i vdekur (subjekti poetik) + kuja e vetmisë (vaj) = shkretëtira e Saharasë.

Jurij Lotman shkruan: "Vepra e artit është modeli i kufizuar i një bote të pakufizuar. Ajo është imazhi i një realiteti tek një tjetër."³ Natyrisht kjo përpjekje për të zbuluar se si u krijua teksti "Saharaja" është thjesht një persiatje.

3 Jurij Lotman- The structure of artistic text, London- 1991.

Vilson Blloshmi, pikturë nga Aleksandër Vreko



1 Vilson Blloshmi, Vepra I, Tiranë, 2008, poezia "Saharaja", f. 85.

2 Po aty.

“POSTMODERNIZMI” I FLORESHA DADOS

Një vepër e rrallë që ndriçon fort thelbin
e letërsisë dhe poetikat e saj

Nga Mira Meksi

Të udhëtosh labirinteve të teorisë së letërsisë, labirinteve të studimit shkencor të letërsisë, që e trajton këtë të fundit si një fenomen kulturor, por jo vetëm, nuk është punë e lehtë. Aq më shumë për një krijuese letrare, në rastin tim, që shkrimësisë, letërsisë pra, i qaset më e shumta intuitivisht. Ose krejtësisht intuitivisht, dhe që në poçarinë e krijimit ka vetëm baltë shpirti dhe një barrë eksperience zëmre për të ndërtuar veprën. Porse ka raste kur një udhëtim i tillë bart aventuratë mrekullueshme... Është aventura e përballjes së alkimisë me shkencën, e përzierjeve okulte të elementeve, e realiteteve paralele, e spekulimeve metafizike, mistike, magjike me studimin e rreptë, të

saktë, erudit, përcaktues... Dhe poçari i shkrimësisë gjendet ballë pasqyrës së teorisë së letërsisë, që herë i jep një imazh të shformuar si portretet e Bacon-it, ku ai gjithsesi e rinjeh veten, dhe herë një imazh aq të qashtë, sa i mbetet vetëm të mbyll sytë fort që mos verbohët... Ia vlen barra qeranë.

Një aventurë të tillë përjetova këto kohë me leximin e një vepre të jashtëzakonshme që ka dalë në qarkullim kohët e fundit, botim i Akademisë së Shkencave: Monografia shkencore “Postmodernizmi-poetikë e antirregullit”, vepra më e fundit e studiuese së shquar erudite të teorisë së letërsisë, Floresha Dados. Leximi i saj më shtyu të bëja disa hulumtime në lidhje me studime të këtij lloji te ne, për të pasur



një tablo më të plotë në këtë drejtim.

Do të përpiqem të bëj një prezantim modest dhe sa më shpjegues të kësaj vepre të madhe, diturake, të shkruar mrekullisht bukur, për të qenë sërish një këmbanëz vlerë- treguese në kaosin e vlerave-antivlerave që mbizotëron tek ne. Një këmbanëz, e cila me tringëllimën e saj mëton të tërheqë vëmendjen leximore të profesionistëve të fushës, mësuesve të letërsisë, studentëve që janë të detyruar të “gëlltisnin” vetëm punimet, më së shumti mediokre, të pedagogëve të tyre, kritikëve të letërsisë (Medet sa të paktë dhe sa të pavaditur janë shumica!) apo mëtonjësve-kritikë letrarë, të shkrimtarëve, lexuesve...

“Postmodernizmi-poetikë e antirregullit” vjen për herë të parë në një rrokje të gjerë, sa teorike, aq dhe interpretuese të veprave të letërsisë shqipe, në lidhje me poetikën postmoderniste, një dukuri kjo e pa trajtuar në përmasa kaq të gjera në studimet letrare shqiptare.

Shfaqja e estetikës postmoderniste në letërsinë shqipe, sidomos pas viteve '90, nuk perceptohet thjesht si një kureshti, shkërbim apo si një proces krijues në kushtet e lirisë së krijimit, por si shpërfaqje e një ndërgjegjeje dhe intuitede të re krijuese, por edhe i një marrëdhënieje të ndryshme me lexuesin. Bindja e kësaj teoricieneje është e qartë që në krye të herës: nëse kjo estetikë do të mbetej në parapëlqimet e një krijuesi, do të bëhej fjalë për një dukuri individuale, por nëse ajo shfaqet si prirje në krijimtarinë e disa shkrimtarëve, atëherë bëhet fjalë për një risi në procesin letrar, e cila ka shkaqe të jashtme dhe të brendshme.

Thelbi metodologjik i qasjes shkencore të studiueses është se, interpretimi i postmodernizmit në romanin shqiptar nuk mund të kuptohet si një proces letrar i mëvetësishëm, pa shtratin filozofik dhe teoriko-letrar mbi të cilin zhvillohet. Andaj struktura e kësaj vepre ngrihet mbi dy boshte themelore: *teorik dhe praktiko-letrar*.

Duke kaluar nëpër këto dy plane, autorja ngre një varg pikëpyetjesh që i dalin nga përballja me disa trajtime të teoricienëve të huaj, që janë marrë posaçërisht me këtë dukuri, si edhe me vetë raportin e disa romaneve të pas viteve '90 me letërsinë në përgjithësi dhe veçanërisht me lexuesin. Studiuesja ka bindjen se letërsia ndjek destinin e vet, por detyra e kritikut letrar është të depërtojë në thelbin e lëvizjes letrare, për të kuptuar raportin midis importimit të saj skematik dhe të qenit produkt i natyrshëm i intuitës krijuese, si kusht për të interpretuar se ç'është



kjo lloj letërsie dhe cila mund të jetë perspektiva e lëvrimit të saj. Andaj ndalja në mëdyshjet e kritikës mbi letërsinë postmoderniste është tepër e rëndësishme për autoren, sepse, sipas përcaktimit të saj, kritiku i romanit postmodernist hyn në një strukturë jashtëzakonisht delikate marrëdhëniesh ndërsubjektive, pozicione ligjërimore dhe tekstore që ndërlikojnë perceptimin artistik.

Ndonëse në thelbin e vet kritika mbi tekstin postmodernist përpiket të ndjekë qasjet që ekzistojnë ndërmjet *tekstit dhe sistemit*, midis *tekstit dhe teorisë*, ndonëse midis veprës dhe kritikës ekziston një ballafaqim i dy ndërgjegjeve, i dy ligjëratave, i dy metodave etj, ajo konfirmon parime të reja, që burojnë nga vetë thelbi i letërsisë që interpreton. Është tepër interesante pikëpamja e F.Dados, sipas së cilës, roli i kritikut dhe natyra e kritikës ndryshojnë dhe përshtaten, çka nxit trazirë opinionesh në mjedisin letrar dhe kulturor. Duke pohuar faktin se në kritikën postmoderniste kemi përpjekje për të braktisur mënyrën sistemike të analizës dhe për të vlerësuar qasjen “anti rregull”, autorja vë në dyshim pikëpamjen se mendimi i qëllimshëm i autorit nuk mund të dihet saktësisht. Kritika e thyerjes së rregullave sjell mëdyshjet : ç’lloj kritike kemi sot ? A ndodhet në krizë kritika letrare ? Sipas mendimit të autores së Monografisë analizat tona kritike për këtë lloj romani, kanë një lloj njëtrajtësi, që buron nga vështirimi kryesisht sipërfaqësor i teknikave formale dhe fare pak merren me efektin që ushtrojnë ato te lexuesi. Këtë ajo e konsideron si “krizën” themelore të mënyrës se si lexohet romani ynë postmodernist dhe shkallës së mundësisë për t’u shpjeguar ai. Natyrshëm del mëdyshja tjetër: a është e mundur të shpjegojmë një roman postmodernist, i cili është i paparashikueshëm, me raporte të çuditshme të brendshme dhe të jashtme?

Çështja më interesante me të cilën merret studiuesja, mendojmë, është teza, e hedhur nga disa teoricienë të huaj mbi *vdekjen e teorisë dhe kritikës postmoderniste*. Kjo ndodh sepse, siç vëren Dado, në studimet letrare vetë teoria postmoderniste nuk është konsoliduar në mënyrë përfundimtare.

Studiuesja duke iu referuar shumë veprave të botuara në letërsinë shqipe përgjatë tri dekadave të fundit provokon disa sfida që i dikton kjo teori, por sidomos vetë krijimet letrare të autorëve tanë. Kështu, problemi i thyerjes së kufijve gjinorë në romanin e sotëm postmodernist krijon diskutim mbi atë që duhet të përcaktojmë se në ç’masë një vepër përfaqëson gjininë e romanit, apo të hetojmë se sa romani i sotëm postmodernist zgjeron strukturën formale të gjinisë, duke krijuar një identitet të ri ?

Në studimin “*Postmodernizmi-poetikë e antirregullit*” referuar boshtit teorik, kapitujt kushtuar tipareve të modernizmit dhe postmodernizmit, përbaljes me realizmin, parë në plan përjasës, nuk janë konceptuar si informacion i ri, por si shtrat që kanë krijuar mundësinë e analizave origjinale të veprave, mbas viteve ’90 (R.Qosja edhe

më parë), ku tiparet e estetikës postmoderniste shfaqen në forma dhe përmasa të ndryshme. Është e jashtëzakonshme, e admirueshme puna dhe qëmtimi që i ka bërë studiuesja Dado prurjeve ndër vite në letrat shqipe . Ajo interpreton në mënyrë mbresëlënëse një numur shumë të gjerë romanesh ku qëmtton dhe nxjerr në pah një sërë aspektesh postmoderniste të narracionit, të mënyrës si janë konceptuar personazhet, të raporteve kohore dhe hapsinore, të trajtave të paparashikueshme ligjërimore, të dukurive intertekstuale dhe të shumë teknikave postmoderniste që trajtohen për herë të parë në një rrokje kaq të gjera.

Tejet interesante shfaqen në këtë studim pikëpamjet e autores mbi prishjen e kufijve dhe *specifikave gjinore* në romanin shqiptar

postmoderniste u shfaq më vonë se lulëzimi i natyrshëm i postmodernizmit në letrat botërore, autorja ka synuar të na japë tiparet specifike, të qëndrueshme apo të variueshme të poetikës postmoderniste tek autorët shqiptarë.

Përpos kësaj, në klimën e opinioneve të ndryshme te teoricienëve të huaj autorja guxon të pyesë: çfarë nuk shkon me postmodernizmin, në përgjithësi në letërsinë e sotme? A është zhvillim letrar që shpreh një filozofi të pranueshme ? A mund të quhet vlerë prirja e disa veprave të letërsisë së sotme drejt copëzimit, përkohësisë, paqartësisë, mohimit, mëdyshjes...?

Sfida e thekshme e studiueses janë vetë pyetjet që ajo ngre: a erdhi *natyrshëm kjo praktikë letrare*

në romanin shqiptar të tri dekadave të fundit ? A ishte imitim trendesh poetike që Evropa i kish kaluar më parë, apo ndikime intuitive mbi kuptimin e realitetit dhe të letërsisë, në qasje të reja, në kontekste të reja


Ndonëse sfida më e mprehtë që ndërton F.Dado është çështja se për kë shkruan shkrimtari postmodernist dhe ç’lloj lexuesi parakupton? Sa e tërheq në të vërtetë ky roman lexuesin e sotëm ?

Studiuesja guxon të polemizojë me teoricienë të huaj lidhur me dilemën e madhe të shekullit XX dhe XXI mbi *kuptimin e artit* në përgjithësi, me pikëpamjen se “nuk ekziston një përkufizim i vetëm mbi artin”. Specialiste e teorisë së letërsisë ajo ka dhe shpreh një vizion të qartë lidhur me këto pikëpyetje dhe dilema.

Përsa i përket të ardhmes së postmodernizmit, autorja na njeh me faktin se teoricienët nuk kanë arritur ende të përcaktojnë nëse ky proces letrar ka përfunduar tanimë, apo se kur mund të përfundojë. Por, përse i përket letërsisë shqipe, ajo shpreh bindjen se poetika postmoderniste nuk është në apogjeun e lulëzimit të vet; fakti që një pjesë e shkrimtarëve i janë rikthyer poetikës realiste, simboliste, realizmit magjik e më gjerë, tregon se kjo letërsi nuk i ka të përcaktuara njëherë e përgjithmonë tiparet e saj. Gjithsesi, me një formim të qartë teorik mbi thelbin e letërsisë F.Dado shpreh konceptin teorik se “letërsia është gjithnjë në

lëvizje dhe kërkim të vazhdueshëm; jo thjesht si trill, por nën ndikimin që rrethana të caktuara të jetës së shoqërisë shkaktajnë përjetime, kundërshti, jo thjesht dhe vetëm në aspektet përmbajtjesore të saj, por edhe në sistemin e konfigurimit”.

Vepra e çmuar “*Postmodernizmi-poetikë e antirregullit*” ndonëse si monografi shkecore ka objekt një çështje themelore, *postmodernizmin në romanin shqiptar*, ajo në të vërtetë zhvillon një sistem të tërë teorik, që ka të bëjë me thelbin e letërsisë dhe poetikat e saj. Po e ritheksoj atë që thashë në krye të herës: pikërisht për këtë specifikë kaq me vlerë, ajo i shërben formimit teorik të kritikëve, mësuesve të letërsisë, studentëve, shkrimtarëve...



postmodernist. Apo diskutimi nese kjo formë e re narrative shënon shkuarjen drejt fundit të narracionit në prozë, apo bëhet fjalë për një zhvillim kalimtar, që do të shkojë drejt zbehjes ? Nëse futja e shumë citime, arsyetimeve teorike mbi letërsinë dhe shumë çështje të tjera, e cënon vlerën artistike të romanit postmodernist ? Çfarë lloj poetike kemi në këtë rast ? A krijon shqetësim mënyra se si konfigurohet *personazhi* në romanin postmodernist, etj.

Vlera e padiskutueshme origjinale e studimit të F.Dados qëndron në faktin se nuk ndalet thjesht në aspekte teorike dhe në interpretime konkrete te letërsisë së sotme, por shtron para lexuesit profesionist pikëpyetje dhe sfida për diskutim. Duke vëzhguar faktin se në letërsinë tonë poetika

Kënga e Fundit e Marko Boçarit

fragment novele nga

FAIK BALLANCA

Ndoqëm po atë taktikë. Natën marshonim, ndërsa ditën flinim guvave dhe pyjeve, pasi kishim vendosur roje të forta përreth. Një mëngjes një nga rojet tha se kishte dëgjuar zhurmë këmbësh. Ai thirri, po zhurmat u larguan me ngut, si diçka që rrëshqet mbi gjethet e kalbura, të mbetura nga vjeshta e vitit të shkuar. Markoja u vrenjt. Armiku mund të na kishte zbuluar dhe atëherë do të ishte tepër e vështirë për t'ia arritur qëllimit. Dërguam një patrullë zbulimi me Zervën, Pilon dhe Thanas Tuzën. Ata u kthyen pas dy orësh dhe nuk zbuluan dot asgjë, veç disa gjurmëve të dyshimta që mund të ishin edhe gjurmët e kafshëve të egra të pyllit. Të gjithë u qetësuam, veç Markos.

Mbrëmja ra mbi pyll si një rrobë e ngrohtë, e leshtë. U bëmë gati për marshim. Markoja na tha se, po të mos na diktonin atë natë, do të kapërcenim rreshtat e fundit të rrethuesve dhe mund t'í godisnim përpara se të largoheshim më tej. Ecnim në të errët dhe mezi shquanim siluetën e shokut që ndodhej përpara. Siç ndodh zakonisht në marshime, na dukej sikur ishim në Sul, nëpër shtëpitë tona, nëpër shkëmbinjtë e njohur. Toka e butë zhytej nën nallçat e shojeve. Doli hëna si një top i hedhur në male. Hijet u stërgjatën. Retë u shkriftuan në qiell si stereja e Mesolongjit kur deti tërhiqet në zbatice. Bunacë. Befas, andej nga lindja shkrepëtiu. Ajri ishte i ngrohtë dhe vakësia dukej sikur mbetej me drurë e varej me përtaci përdhe. Pritëm të binte shi, po nuk ra. Në lindje përsëriteshin shkrepëtimat, ndërsa mbi ne ndriçonte një hënë e bardhë. Diku u ndalëm. Shoku që kisha përpara bëri me shenjë që të heshtja. Eca pa zhurmë në majë të gishtave. Udhë ishte e zënë. Përpara nesh kishte dytri çadra dhe një mori ushtarësh që flinin si të vdekur. Ishin shtrirë përdhe pranë e pranë dhe s'kishin asgjë në trup, veç rrobës së leshtë dhe armëve që u shkëlqenin. Hëna u ndriçonte fytyrat dhe shamitë e bardha, të mbështjella si qefinë rreth kokës. Midis drurëve kishte kuna të varura dhe, me sa duket, njëri nga ata që flinin atje foli nëpër gjumë. Kuna u lëkund dhe ne kujtuam se foli dikush nga ne.

“Ç'është ai kapedan i marrë që i ka shtrirë këtu në mes të udhës”, thashë me vete.

Kush foli? - pyeti Markoja nën zë.

Pamë njëri-tjetrin, po nuk e gjetëm dot. Zerva eci përpara. U përkul mbi një kunë. Nxori thikën dhe vrau dikë. Pastaj vajtën të tjerë. M'u duk sikur e ndjeva erën e gjakut dhe s'di sepse ngrita kokën, po s'pashë as yje e as hënë, sikur qielli të ishte verbuar. Bari i shtypur dridhej nën erën e vakët dehëse. U lëkund një pemë aty pranë dhe ranë gjethet. Befas dikush thirri me një zë të çjerrë, që u pasua nga zëra të tjerë.

Na vranë toskët! Na therën!

Ishin disa zëra njëherësh, që vinin njëri pas tjetrit. Ata që flinin u zgjuan, u ngritën nga dheu, kërcyen nga kunat dhe zhveshën armët, akoma të trullorur nga gjumi. Pylli shkëlqeu.

Na kishte futur Zerva në atë shteg. Ai kishte qenë pararojë. I kishte gjetur të gjithë të përgjumur dhe nga shamitë e bardha si turbanë, kishte pandehur se ishin turq.

Ne shkuam pas Zervës.

Na vranë toskët!

U mbloodhëm menjëherë rreth Markos dhe për herë të parë e pamë të hutuar. Nakla ia priste krahët. Na udhëhoqi në një anë të pyllit, po përsëri na dolën çadra përpara dhe dikush ulëriti po ato fjalë: “Na vranë toskët!” Pas nesh u dëgjuan zëra të tjerë, që nuk ishin zërat e shokëve tanë:

O burra, toskë, pini gjak gegë!

Tradhti!

Ishim të rrethuar. Dikush na nxiste njëri kundër tjetrit. Zërat vinin nga vende të ndryshme. Nisi beteja dhe askush nuk po e merrte vesh se si ndodhi. Ngatërroheshim midis drurëve, na bëhej sikur na godisnin hije, sikur na ngjiteshin kulpra nëpër këmbë. Omer Vrioni e kishte ngritur me kujdes kurthin dhe njerëzit e tij thërrisnin po ato fjalë nga majat e pemëve. Këtë e mësuam më vonë.

Markoja u sul me rrëmbim përpara. Rendëm pas tij dhe u përpoqëm të mos e humbnim sysh në atë zallahi.

Ku janë pashallarët? - thërriste ai. - Ku janë pashallarët?


Shtatë bejlerë mbetën të vranë nën këmbët tona. Nën nallçat e shojeve mbinin vurrata e gjaku nuk mpiksej, po rridhte i valë në atë pyll të vakët. Markoja çau një çadër me thikë. E mbërtheu në sytë tanë Ago Vasjarin, e tërhoqi për mjekre dhe kur e ngjokën, ia nguli thikën në fyt, duke i thënë:

Plaku i Litharicës është ngjallur vurrkollak. Aliu të kërkon hakun.

Agoja u rrëzua në këmbët e tij. Markoja mori frymë e lëshoi krahët. Tamam atëherë një negër, që ishte shtrirë përdhe, e qëllloi dhe e plagosi në ije. Ne hapëm zjarr mbi të dhe e lamë të vdekur, ashtu siç qe i shtrirë. Iu afruam stratarkut, po ai na mbajti larg. E lidhi vetë plagën.

Bjeruni trompetave! - urdhëroi pas pak. - Bjeruni trompetave që të ushtojë pylli. Unë nuk kthehem më pas. Do ta gjej të gjallë Omer Vrionin në këtë pyll, ashtu siç gjeta Agon.

Trompetat tona zunë të binin dhe tingujt rendën nëpër pyll si ca gurë që përplasen. U mbloodhëm të gjithë aty. Përtej drurëve u dukën mirditorët me Lleshin e Zi në krye, vëllain e kapidanit të Oroshit. Zhurma e



trompetave u tërhoqi vëmendjen mbi ne.

Na vranë toskët! - klithi dikush mbi pemë.

Hapën zjarr dhe pylli u ndriçua sikur të kishte shkrepëtirë. Markoja u rrëzua. Në çast plasi një përleshje e përgjakshme dhe në atë gjurulldi se kush mundahej të merrte trupin e tij. U ndeshëm gjoks më gjoks. Më në fun Thanas Tuza e hodhi Markon në kurriz. Ne e vumë në mes dhe u tërhoqëm duke shkelur mbi të vranë.

Njerëzit e Omer Vrionit thërrisnin mbi kokat tona: Na therën toskët!

Suluni, o gegë, pini gjak toske!

Suluni, o toskë, pini gjak geqe!

Gjuha jonë deformathej nga klithmat e tyre dhe ata përsërisnin po ato fjalë, si kukumjaçkat që njohin vetëm një klithmë. Ishin turq apo çekrezë?

Herë-herë dëgjonim nga një krismë nga pas, por tani nuk na bënte asgjë përshtypje. Rreshtat e turqve i çamë më lehtë dhe dolëm nga rreziku. Premë dru e shkurre përreth, bëmë një vig të fortë e shtruam një rrobë të leshtë. E ulëm ngadalë Markon. I vendosëm armët, kitarën, trompetën dhe një flamur turk pranë këmbëve. Thanas Tuza mezi e lëshoi. Markoja ishte i verdhë. Herë-herë rënkonte në jerm. Ashtu duke ecur, unë hidhja sytë nga ai dhe hapat e mia më dukeshin si hapat e valles së grave të Sulit, që ishin hedhur me këngë në greminë.

Kostandin Boçari doli në krye të rreshtit dhe përsëriste herë pas here:

Unë jam i vëllai dhe nuk qaj. Asnjë të mos qajë.

Dielli na gjeti në rrugë. Markoja zuri të lëvizte qepallat. Buzët dhe vetullat i dridheshin dhe mua më dukej sikur thoshte diçka, që nuk e dëgjonte dot askush nga ne.

“Armët i kam pranë, po s'luftoj dot. Kitarën e kam pranë, po s'këndo dot. Po vdes... Këmba ime nuk do të shkelë më kurrë mbi shkrepat e Sulit. Meteorët e përgjakur s'patën vend për këtë lëng të sertë që më rrjedh nga plagët dhe që është jeta ime. Se gjaku i kombit tim është shprishur e rrjedh nëpër Europë, kudo që ngre krye liria. Ne jemi gladiatorë që e shpërthyem arenën.

Karpenisi! Mbi kokën time djeg dielli i huaj i Eladës. I verdhë si limon ky qiell. Mbi buzën time po rreshken kripërat e fundit. S'kam një bulë ujë dhe zemra po më çahet nga malli. Nuk mundem të këndo. Fytyra e Krizesë dhe e tim biri buzëqeshin përtej pyllit të gjelbër me ullinj. Ku jeni? Era gënjeshtare lot me mua dhe shpërndan mall e këngë të vjetra lufte, si atëherë kur ndodheshim tek Pesë Puset, në Qafë, apo në kështjellën e shën Venerandës.

Ku vemi? Ky vig që lëkundet më kujton djepin e nënës që më merrte gjithmonë në shpinë. Me djepin tim e të Kostandinit ime më u çonte barut luftëtarëve. Nga gjumi më zgjoi një krismë dhe një krismë po më vë në gjumë. Më ngadalë, ju shokë që më mbartni! S'më shpini dot në Seleidë. Eshtrat e mia do t'í presë një tokë tjetër. Po vij, Mesolongj. Është mesditë. Stërkat e dallgëve vrapojnë mbi krahët e baticës dhe rrethojnë tërë brigjet e tua me shkumë të bardhë, që mërmërit se unë po vdes. Vërtet po vdes, po mos mbani zi. Se unë nuk jam më trimi i kombit tim. Në atë arenë të vogël të huajt kanë ngjallur përçarjen e llahtarshme: vëllavrasjen. Vetëm kjo na ka prishur. Unë jam një gladiator që e gjeta rastësisht derën hapur. Dhe u përpoqa që të mbroj këtu lirinë që gëzoja në malet e mia, në sajë të armëve që kam në trup. Gjaku im vritet akoma. Kush e di për sa kohë? Kush e di se kur liria do të trokasë mbi atë dhe të zhuritur pëllëmbë e gjak, siç po troket tani në Eladë. Shpejt. Shumë shpejt.

... Më dhemb diçka. Diçka s'e kreva...

Po mbërrijmë. Hapuni porta, paçka se qepallat e mia po mbyllen dhe shokët nuk i shquaj dot! Më varrosni pranë fortifikatës “Gjergj Kastrioti”, që hija e tij të më qetësojë...

Një orë udhëtim

tregim nga

JEFFREY ARCHER

Kelley e bënte gjithmonë rrugën e kthimit për në kolegji me makina të rastit dhe në fshehtësi të plotë nga prindërit. Ajo ishte e bindur se ata nuk do ta lejonin kurrë një gjë të tillë.

Babai e kishte bërë zakon që ditën e parë të çdo semestri ta shoqëronte të bijën deri tek stacioni i trenit me makinën e tij. Ajo sillej lartë e poshtë platformës derisa të sigurohej se ai kishte marrë rrugën e kthimit për në shtëpi. Më pas përshkonte në këmbë një distancë prej rreth tre kilometrash në drejtim të autostradës. Fakti që Kelley preferonte të udhëtonte për Stanford me makina të rastit, dhe jo me tren apo autobus, bazohej mbi dy arsye të forta. Dymbëdhjetë udhëtime në vit me makina të rastit i jepnin mundësinë të kursente mbi njëqind dollarë, shumë kjo e paarritshme për babain e saj, sidomos pas humbjes së vendit të punës në ndërmarrjen e ujit. Babai dhe nëna kishin bërë sakrificat e nevojshme që ajo të shkonte në kolegji, por të thuash të vërtetën, kjo nuk është se kishte sjellë ndonjë pështjellim të mëtejshëm të gjëndjes së tyre ekonomike.

Arsyeja e dytë për këtë përzgjedhje ishte se ajo dëshironte të bëhej shkrimtare menjëherë mbas mbarimit të studimeve. Në tre vitet e fundit, gjatë udhëtimeve të shkurtëra nga Salinas në Palo Alto, ajo kishte ndeshur njerëz tepër interesantë që me dëshirën e tyre kishin ndarë përvojat vetjake të jetës me një të panjohur të cilën vështirë se do ta hasnin sërish.

Dikush kishte punuar si korier i bursës në Wall Street gjatë periudhës së Krizés ekonomike, një tjetër kishte marrë medaljen e Yllit të Argjentë në Monte Cassino, por më i preferuari i saj ishte dikush që kishte kaluar një ditë të tërë duke peshkuar me Presidentin Roosevelt.

Kelley kishte gjithashtu parime shumë të forta që e ndihmonin për t'i zgjedhur njerëzit me të cilët ajo mund të udhëtonte. Drejtuesit e kamionëve ishin në krye të listës meqënëse ata kishin vetëm një gjë në mendje. Më tej vinin të gjitha mjetet që bartnin dy ose tre të rinj. Në të vërtetë, ajo i shmangej shumicës së shoferave nën moshën gjashtëdhjetë vjeç, dhe veçanërisht atyre që zinin vend pas timonit të një makine sportive.

Makina e parë që uli shpejtësinë kishte brenda dy të rinj, por nëse kjo nuk përbënte një paralajmërim të mjaftueshëm, kanaçet e zbrazura të birrës që ndodheshin në vendet e pasme sigurisht që ishin një paralajmërim i vërtetë. Të zhgënjyer, të dy të rinjtë tundën kokën në shenjë mohimi dhe pas disa fishkëllimave të forta dhe mosaprovuesë u larguan në drejtimin që kishin marrë.

Mjeti tjetër që u ndal buzë rrugës ishte një kamion, por ajo as që e mori mundimin t'ia hidhte sytë drejtuesit të saj dhe thjesht vazhdoi ecjen. Shoferi i ra burisë me një farë neverie dhe përfundimisht kamioni u largua me shpejtësi.

I treti i radhës ishte një kamion i vogël e i hapur me një çift në vendet e para i cili, me të vërtetë, u duk premtues deri në momentin kur Kelley vuri re një qen bariu të racës gjermane që të linte përshtypjen e një kafshe të uritur tek prehej në ndenjësën e pasme. Me mirësjellje ajo shpjegoi se qentë i shkaktonin alergji - kuptohet, përveç qenit të racës spaniel që kishte në shtëpi dhe që e adhuronte aq shumë.

Pak me vonë ajo dalloj një veturë të markës Studebaker, prodhim i para luftës, që po afrohej me ngadalësi. Kelley u kthye nga vetura, buzëqeshi dhe ngriti lart gishtin tregues. Makina uli shpejtësinë dhe u ndal në anë të rrugës. Me hapa të shpejtë ajo u hodh në krahun e pasagjerit nga ku konstatoi se drejtuesi i mjetit ishte një zotëri i moshuar i cili përkuli trupin në drejtimin e saj tek ulte xhamin.


‘Për ku kështu, zonjushë?’ pyeti ai.

‘Stanford, zotëri,’ u përgjigj ajo.

‘Andej e kam rrugën, hidhuni brenda.’

Kelley nuk hezitoi sepse ai i plotësonte të gjitha kërkesat e saj të rrepta: ishte mbi gjashtëdhjetë vjeç, mbante një unazë martese, ishte i sjellshëm dhe fliste bukur. Me të hyrë në makinë trupi sikur iu zhyt në ndenjësën prej lëkure, por frika e vetme që pati ishte se as i moshuari dhe as vetë makina nuk do të rezistonin deri në fund të udhëtimit.

Në kohën që ai kontrollonte krahun e majtë dhe me kujdes po e rikthente makinën në autostradë, Kelley i hodhi një vështrim të kujdesshëm. Kishte flokë në ngjyrë kafe, monotone dhe të thinjur, një fytyrë verdhacake me rrudha që i ngjante më shumë një lëkure të lodhur nga mundimet e tepërta, dhe mbi të gjitha pinte një cigare që i kolovitej në njërën anë të gojës,



gjë që asaj nuk i pëlqeu aspak. Kishte veshur një këmishë me kuadrata, të hapur pranë qafës dhe një xhakëtë kadife të veshur me lekurë rreth bërrylave.

Njëri nga profesorët e kishte këshilluar shpesh herë se nëse dëshironte të bëhej shkrimtare, përveç përvojës personale në jetë, duhej ta njihte përvojën e pasur jetësore të njerëzve të tjerë. Pavarësisht faktit se i moshuari nuk dukej se ishte një kandidat i përshtatshëm që mund t'i zgjeronte horizontin, rrugë tjetër për ta zbuluar të vërtetën nuk kishte.

‘Falemnderit që u ndalët,’ tha ajo. ‘Quhem Kelley.’

‘John,’ u përgjigj ai tek la timonin të lirë pikërisht në momentin kur i shtrëngoi dorën. Mendimi i parë që pati ishte se ato duar të ashpra ishin duar fermeri.

‘Çfarë po studioni, Kelley?’ pyeti ai.

‘Letërsi moderne amerikane.’

‘Nuk është se kemi pasur dhe shumë letërsi këto vitet e fundit,’ sugjeroi ai. ‘Sigurisht, kohët ndryshojnë. Kur unë studioja në Stanford, vajza studente nuk kishte fare në kompleksin universitar, madje as edhe natën.’

Kelley u habit që John kishte qënë student në Stanford. ‘Çfarë dege keni mbaruar, zotëri?’

‘John,’ ngulmoi ai duke iu referuar vetes. ‘Është vërtetë keq të jesh i moshuar dhe të mos të ta kujtojë këtë fakt një zonjushë e re.’ Ajo qeshi. ‘Kam mbaruar studimet për letërsi angleze, në degën tuaj. Mark Twain, Herman Melville, James Thurber dhe Longfellow, por për fat të keq, nuk kisha rezultate të mira dhe studimet i lashë në mes. Diplomën nuk e mora kurrë dhe për këtë jam penduar se tepërmi.’

Kelley i hodhi një vështrim tjetër bashkëbiseduesit dhe ndërkohë pyeti veten nëse mjeti do të lëviste gjithë rrugës me levën të ngujtur në marshin e tretë. Pikërisht kur po bëhej gati ta pyeste se përse i kishte braktisur studimet, ai ndërhyri, ‘a mund të marr guximin t’ju pyes se cilët janë gjigantët e sotëm të letërsisë amerikane?’

‘Hemingway, Steinbeck, Bellow dhe Faulkner,’ u përgjigj ajo.

‘Keni ndonjë të preferuar?’ pyeti ai pa ia hequr sytë rrugës.

‘Po, kam. Në moshën dymbëdhjetë vjeçare lexova *Vitet e Zemërimit*, që për mua është një nga romanet më të arritur të shekullit të njëzetë. “*Dhe fakti i vogël ulëritës që jehon në histori: shtypja nuk bën gjë tjetër veçse forcon dhe bashkon të shtypurit.*”

‘Të admiroj,’ tha ai, ‘ndonëse libri im i preferuar do të mbetet gjithmonë *Mbi Minjtë dhe Njerëzit.*’

“*Duhet të kesh arsye që të jesh djalë i mirë,*” u shpreh Kelley. “*Më duket nganjëherë se e vërteta përputhet krejtësisht me të kundertën. Merr, për shëmbull, një të ri shumë të zgjuar dhe menjëherë do ta vësh re se nuk bëhet fjalë aspak për një djalë të mirë.*”

‘Nuk besoj se provimet keni për t’i braktisur ndonjëherë,’ tha Johni duke buzëqeshur me qesëndi, gjë që i dha rastin asaj ta fillonte serinë e pyetjeve.

‘A nuk më thoni, me çfarë u morët kur u larguat nga Stanford-i?’

‘Im atë donte që unë të punoja në fermën e tij në Monterey, gjë që bëra për dy vjetë, por nuk ishte punë për mua ndaj dhe rebelova dhe fillova punën si shoqërues grupesh turistike pranë liqenit Tahoe.’

‘Duhet të ketë qënë punë zbavitëse.’

‘Sigurisht që ishte. Dama kishte plot, por pagesa ishte e mjerë. Kështu, bashkë me shokun tim, Ed-in, vendosëm të udhëtonim lartë e poshtë bregdetit të California-s me synimin që të mblidhnim specie biologjike, por edhe kjo, për fat të keq, rezultoi jo fitimprurëse.’

‘U përpoqët të gjenit një punë më të rregullt?’ pyeti Kelley.

‘Nuk mund të them se po, të paktën derisa shpërtheu lufta, sepse më pas fillova punën si korrespondent lufte për gazetën *Herlad Tribune.*’

‘Uau, duhet të ketë qënë me të vërtetë fantastike,’ tha Kelley.

‘Të ndodheshe pikërisht atje, në mes të betejës dhe pastaj t’i raportoje popullit në atdhe gjithçka që kishe parë me sytë e tu.’

‘Nuk ishte problemi aty. Problemi ishte se isha aq shumë i angazhuar në ato që ndodhnin në fushën e betejës sa që mbas breshërisë së plumbave që mora në brinjë u desh të më transportonin me anije në Shtetet e Bashkuara. Për pasojë, humba jo vetëm punën si korrespondent, por edhe gruan e parë.’

‘Gruan e parë?’

‘Mos vallë harrova t’ju përmend gruan e parë Carol-ën?’ pyeti ai. ‘Martesa me Carol-ën zgjati trembëdhjetë vjetë derisa në

jetën time u shfaq Gwyn-i, martesa me të cilën përfundoi pas pesë vjetësh. Që t’ia jap hakun, gjë e vështirë kjo, Gwyn-i më dhuroi dy djem të mrekullueshëm.’

‘Çfarë ndodhi kur e morët veten dhe plagët u shëruan?’

‘U mora me emigrantët e shumtë që po vërshonin në California në periudhën pas luftës. Jam vetë me origjinë gjermane, e dija se çfarë hiqnin ata njerëz ndaj dhe ndjeja keqardhje për ata.’

‘Me këtë punë jeni marrë gjithë jetës që atëherë?’

‘Jo, kur Presidenti Johnson mori vendimin për ta pushtuar Vietnam-in, *Herlad Tribune* më ofroi përsëri punën që kisha pasur. Me sa duket e patën të vështirë që të gjenin njerëz të cilët do ta konsideronin dërgimin në Vietnam si një hap të mirë në karrierën e tyre.’

Kelley qeshi. ‘Të paktën ketë radhë mbijetuat.’

‘Kjo do të kishte ndodhur vetëm në qoftë se CIA nuk do të më kishte kërkuar të punoja njëkohësisht për ta.’

‘A më lejohet të pyes se çfarë bënit për ata? tha ajo tek i hodhi një vështrim më të kujdesshëm të moshuarit.’

‘Shkruaja një version në lidhje me ngjarjet në Vietnam për *Herald Tribune*, ndërkohë që informoja CIA-n për ato që ndodhnin në të vërtetë. Sidoqoftë, kisha përparësi ndaj kolegëve të mi, gjë për të cilën vetëm CIA kishte dijeni.’

Kelley u bë gati ta pyeste se si ishte e mundur një gjë e tillë, por John ia dha përgjigjen përpara se ajo ta hapte gojën.

‘Të dy djemtë e mi, John Jr dhe Thomas, kontribonin në vijën e frontit, pra nëpërmjet tyre unë merrja informacione që kolegët e mi të paaftë nuk mund t’i mirrin.’

‘Gazeta duhet të jetë zbavitur shumë me këtë fakt.’

‘Kam frikë se jo,’ shtoi John. Redaktori më pushoi nga puna në momentin kur mori vesh se unë punoja për CIA-n. Ai më tha se integriteti im si gazetar ishte kompromentuar dhe se isha shndërruar në një njeri tjetër, për mos ta përmendur këtë faktin se paguhesha njëkohësisht nga dy padronë.’

Kelley mbeti gojëhapur.

‘Për hir të së vërtetës,’ vazhdoi ai, ‘nuk kishte se si të mos isha dakord me ata. Sidoqoftë, po zhgënjehesha gjithnjë e më shumë me ato që po ndodhnin në Vietnam dhe madje arrita ta vë në dyshim moralitetin e asaj që po bënim.’

‘Çfarë bëtë përfundimisht kur u kthyet në shtëpi?’ pyeti Kelley që kishte filluar të mendonte se ky udhëtim i shkurtër ishte po aq interesant sa edhe udhëtimi që kishte bërë me personin i cili kishte kaluar një ditë të tërë duke peshkuar me presidentin Roosevelt.

‘Pas kthimit në shtëpi,’ vijoi John, ‘zbulova se bashkëshortja ime e dytë bashkëjetonte me një burrë tjetër. Nuk mund të them se fajin e kishte ajo. Pastaj nuk është se edhe unë mbeta beqar për një kohë të gjatë, shumë shpejt u martova me Elaine-n. Mund t’ju them diçka për të cilën jam shumë i sigurt, Kelley, tre gra janë shumë për një burrë.’

‘Po më pas, çfarë bëtë?’ pyeti Kelley e vetëdijëshme se po i afrohehin kompleksit universitar.

‘Elaine dhe unë u shpërngulëm në Jug ku shkruajta artikuj për lëvizjen e të Drejtave Civile për shumë gazeta paçavure që pranonin t’i botonin pikëpamjet e mia. Për fat të keq rashë në bela kur u përplasa me J. Edgar Hoover-in, refuzova të bashkëpunoja me FBI-inë dhe nuk pranova t’iu transmetoja ato që kisha mësuar në takimet e mia me Martin Luther King Jr-in dhe Ralph Abernathy-n. Në fakt, Hoover-i u inatos aq shumë me mua sa që më vuri etiketën e komunistit. Etiketa nuk ngjiti, kështu që ai filloi të zbavitej duke i kërkuar Shërbimit të Brendshëm të të Ardhurave, IRS-it, t’i hetonte fitimet e mia çdo vit.’

‘Me të vërtetë keni takuar Martin Luther King Jr-in dhe Ralph Albernathy-n?’

‘Sigurisht që po. Pa mendoje një herë, edhe John Kennedy-n. Shpirti iu prehtë në paqe.’

Kur dëgjoi se ai kishte takuar edhe John Kennedy-n, Kelley pa prituri kuptoi se ishte gati të niste një seri tjetër pyetjesh, por në largësi syri i kapi Kullën Hoover të universitetit që vinte duke u zmadhuar vazhdimisht.

‘Çfarë jetë të mrekullueshme që paskeni bërë,’ tha Kelley që u ndje e zhgënjyer nga fakti se udhëtimit po i vinte fundi.

‘Kam frikë se jetën time e paraqita më interesante se çka qenë në të vërtetë,’ tha John-i. ‘Pastaj kujtimet e një të moshuari nuk është se janë gjithmonë të besueshme. Kështu pra Kelley, po ju, ç’keni ndërmend të bëni në jetë?’

‘Dua të bëhem shkrimtare,’ u shpreh Kelley. ‘Ëndrra ime është që pas pesëdhjetë vjetësh, letërsia moderne Amerikane ta përfshijë emrin e Kelley Ragland-it në gjirin e saj.’

‘Nuk ka asgjë të keqe aty,’ tha John-i, ‘por nëse do t’i lejonin një të moshuari t’ju japë një këshillë, atëherë, mos u nxitoni për ta shkruajtur Romanin e Madh Amerikan. Grumbulloni sa më shumë përvojë nga bota dhe njerëzit përpara se të uleni dhe ta hidhni penën mbi letër,’ shtoi ai ndërkohë që vetura u ndal me belbëzim përpara hyrjes së kolegjit. ‘Ju premtoj, Kelley, se nuk keni për t’u penduar.’

‘Falemnderit për udhëtimin, John,’ tha Kelley, tek doli nga makina. Me hapa të shpejtë u hodh në krahun e shoferit për t’i thënë mirupafshim pikërisht në momentin kur ai po ulte xhamin. ‘Historia e jetës suaj me të vërtetë të magjeps.’

‘Biseda me ju ishte një kenaqësi edhe për mua,’ tha John-i. ‘Shpresoj se një ditë do ta mbaj romanin tuaj të parë në duart e mia. Këtë e them ngaqë patët mirësjelljen të ma shprehni admirimin tuaj për veprën time, të cilën, në mos gaboj, e lexuat për herë të parë në moshën dymbëdhjetë vjeçare.’

Përktheu nga anglishtja: Aristidh Shqevi
Oslo, 10.09.2020

Geisha e fjalës
së bukur
poezi nga
NEVIANA
SHEHI

GEISHA E FJALËS SË BUKUR

Jeta ime është një dantellë
prej vargjeshe,
thurur ditën e takimit me ëndrrën dhe të
ëndërruarin.
Nuk jam e paqortueshme, por ndjekëse
e çastit ideal. Po!

Ivasakin e famshme e kam parë veç nga rrëfimet,
por s'më tundon jeta e saj
pëlqej malin Fuxhijama dhe vullkanet e tij.

Natën kur me del gjumi dhe bëhem skllave e pasionit
tim për fjalën,
maska e tjetërsimit që vë në fytyrë përhapet vetvetiu
në gjithë qenien time.

Në atë çast s'jam më unë,
por ajo që dua unë të jem
loja e territ me dritën.

Lëvizja e shtizave s'është gjë përpara lojës së trilleve
të muzës
dhe gishtërinjve të fatit që
krijoj për lirinë time të bardhë.

Lëkurë bute e bukur,
por dhe paksa e trishtë nga ato që s'më pëlqejnë,
sërish eci në rrugicat e heshtura
që më drejtojnë drejtë parajsës.

Si çdo geiko tjetër dhe unë di të përkëdhel,
por më mirë di të vallëzoj me asonacat
valle prej ere dhe fllade pasionesh.

Takimi me te ardhmen
ka ndodhur që në momentet kur i thashë jetës sime:
- ja vlen të të kem.

Kohët ku zhvillohen
aktet e krijimit
janë takimet me djaloshin e brishtë dhe të
paparashikueshëm
të avenysë së zhurmshme,
dhe quhet kohë transformimi,
sepse un kam lindur për të qenë e tillë.

Sa e sa herë e kam mbështetur kokën mbi kimonon time
për të ëndërruar të pavdekshmen.

Të gjithë më thonë se zemra ime është prej letre
apo si një takim i shtrenjtë filxhanash çaji.
S'besoj!

Ne momentin e aktit të shkrimit
unë di të shndërrohem në një llavë dhimbje.
Nata për mua është një mbretëreshë
kurse lexuesit balerinë të së bukurës
koreografia misterioze e valles së tyre
është forca për t'i bërë ballë furisë së dritës.

Unë jam geisha e fjalës
së bukur.

HESHTJA E PIANISTES

Shtëpi e braktisur si një guaskë që klith
Zëra vitesh të shkuar dhe një kalendar koncertesh në
mur.
Pianistja plakë ka vite që ka shkuar,
në shkallë tashmë veten ngjit
vetëm heshtja dhe ndonjë kufomë kujtimesh
e porsa zgjuar nga letargjia.

Pezhishka gri që endi merimanga e zezë
tashmë është kthyer në një eksponat kufomash
nga të gjitha llojet e insekteve:
miza, mushkonja të vockla dhe të mëdha
flutura të çdo lloji...

Njëra prej tyre, dikur vinte çdo natë
në dhomën time,
Tashmë po prehet këtu, në trupin e harresës.

Mos thirr në krye të shkallës,
më thotë bulkthi rojtar,
përndryshe tastierat e ndryshkura të pianos
do të nisin të luajnë nokturnon e Shopenit
dhe fantazma e pianistes plakë
që shëtit çdo natë dhomë më dhomë,
mund të klithë prej tmerrit dhe...
-pastaj?!

Pastaj insektet do të ringjallen dhe
nokturno mund të shndërrohet në një muzikë vajtimi...

Ndonjëherë është më mirë të dëgjosh këshillën e
bulkthave,
-them me vete, sesa të kthehesh në një
personazh thriller nga filmat e Hiçkokut...

Shtëpi e braktisur,
me bar nëpër shkallë,
kufomat e fluturave dhe
një nokturno nga Shopeni
tashmë po hanë njëra-tjetrën.

KISHË E VOGËL NË GJOKSIN TIM

Kur ti ndjen dhimbje mikja ime
një univers i trishtuar
më rëndon përmbi supe
dhe...një dhimbje therëse
më ngacmon vazhdimisht.

S'jam më vetvetja,
por një çast që zvarritet
si qenie pa gjymtyrë.

Më dhemb edhe mua dhe...
pika e lotit sa madhësia e globit
ndahet vete në dy pjesë.



Ç'të bëj për ty mikja ime ?
A do të t'i fal buzëqeshjet e mija
që të të ngrohin disi
për t'u ndjerë pak më mirë
Merri!
Njeriu mund të gjallojë edhe pa buzëqeshje,
por pa miq të vërtetë është vështirë
oh, shumë vështirë.

Që ti të bëhesh mirë, mikja ime
lutjet e mija të pazëshme
ua nis yjeve mbrëmjeve si dhuratë.
(Lutjet e mikes për miken mund të drithërojnë edhe
Zotin)
-ndonjëherë më thonë zërat...

Kur sëmuresh ti,
puls i im zë e rreh vetëm për ty
dhe gjoksi shndërrohet menjëherë
në një kishë të vogël
ku mesha s'mbaron asnjëherë
mikja ime.

Qysh në çastin që u njoha me ty
kam nisur të besoj
në alkiminë e shndërrimit të trupave.

HËNË MBI QYTETIN E DYZET
SHENJTORËVE

Gjithmonë më është dukur
se nimfat e detit
e kanë origjinën prej teje.

Përherë kam besuar
se në ADN-në time
ka diçka nga ty,
nga librat e kaltër,
nga sytë enigmë të peshqve,
por edhe nga çdo dritare shtëpie
që më afron dashuri.

Qytet me gjoks malesh,
që sytë lan në det
dhe kurrë nuk dehet
prej bukurive magjike.

E kam parë trupin tënd të drithërohet
nga një e qeshur vajze,
ndoshta edhe ajo mund të ketë qenë
mbesa apo bija e një nimfe
që ka dalë të pushojë
rastësisht në breg.

Po drithërohem
nga flladi i mbrëmjes
dhe ndjej të rrahurat e zemrës sate
sa herë që zbres shkallëve
dhe përqafohem me valët.

Oh, dua të të fus në bebëzën e syrit
e të të ruaj kujtim deri në amshim.

Kujdes syrin, gjithnjë më thotë një zë
që më vjen nga porti i vjetër:
kujdes, se ky është qytet shenjtorësh
dhe i dyzet magjive
që lahen çdo mbrëmje në det.

Kur për herë të parë u putha këtu
me një bukovile
mbeta e dashuruar për jetë.

Dhe sa herë që shikoj
pafundësinë e qiellit të natës,
një nimfë më pëshpërit:
tani drita e hënës do të derdhet
mbi qytetin e dyzet shenjtorëve
që bëjnë magji dashurie.

Jam fik deti

cikël poetik nga

THANAS DINO

KORRJET

Nuk janë turistë. Janë kombajnat në rrugë
Filluan korrjet. Erdhi muaji i bukës .

Gruri ul kokën i menduar
Kujton jetën e vet disa muajshe.

Kombajnat si kuaj vijnë rrotull fushës
O, grurit të ri si i priten gjunjët !

Mblidhet mënjanë e trishtuar kashta
Fusha si fletë, mund të shkruash reportazhe .

Kështu të vetmuar ai tokën lë
Por nën lëkurën e saj mbeten rrënjët.

HIDHËRIMI I NJË STINE

Ç' mërzi e madhe e ka kapur vjeshtën
që zverdhët e zverdhët ?
(Pemët si me varak
fillojnë odisetë e vogla të gjetheve).

Pas pak do të vijë dimri
Dimri gri .
Si parandjenjë rrinë mbi tokë
mjegullat e tij.

VAJZË E VALËVE

Ja bregu i detit . Ja shkëmbi „Ku është vajza ?
Deti hapet e mbyllet si fustani i saj .

MYZEQEJA NË MBRËMJE

Të huton gjërësia e fushës, të merr sytë .
Mbrëmjet e verës vijnë vonë .

Toka me vapë u mërzit ,
Një grumbull resh po shpejton
Diellit si jastëk t' i rrijë.

Janë gati t' i hapin rrugën detit
Pemët që mbyllin horizontin.

Të huton gjërësia e fushës, të merr sytë .

ME FYTYRË NGA NJERËZIT

Zëmra m' u hap si lëndinë
erdhën fshatarët të mbjellin .

Verën e ardhëshme do të mbushen
me lule dielli
me fytyrë nga njerëzit.

*Këto poezi janë botuar për herë të parë në gazetën “ Drita”,
23 korrik 1972.*

NJË MËNGJES -

Më 25 qershor, në orën pesë,
gjithçka m' u duk jashtëzakonisht e pastër.
Uji i detit m' u duk tjetër,
tjetër m' u dukën bananet.
(Deti i porsalindur
Pemët të sapombira)
Dhe vetja mu duk tjetër.
Atëhere e kuptova
se mundet që unë
të tretësja e të bëhesha
banane me gjethe të gjatë, horizont, vajzë, ujë deti.

TOKA DHE DETI --

Ne të dy
jemi toka dhe deti.

Jemi mbushur me iriq,
peshq , guaska dhe qiparisa.

Shumë gjera i japim njeri tjetrit
si toka detit.

Mbi të dy derdh dritë të argjendë
buza e prerë e hënës.

Si toka detin
duam njeri tjetrin.

DHËRMIU

Për pesëmbëdhjetë ditë
këtu fjetëm krah për krah me detin.

SARANDA

Saranda si hënë e re
rënë në breg të detit,
uji i thellë, kështu
mbetur që nga kohët e vjetra .

NDARJA

Si kërmilli
gjithçka do të marr me vete
dhe këngë,
dhe heshtje .

UNË JAM FIK DETI

Gjethet e tij janë duart e mia,
Rrënjët e tij janë zëmra ime,
Trungu i tij janë vitet e mia,
Qumështi i tij , pikon pik pik, është jeta,
Arkitektura e tij e çuditshme është gjuha ime.

Unë jam fik deti.

Këto poezi janë botuar për herë të parë
në nr.10 të revistës “Nëntori”, të vitit 1972.



DRAMATIKA E NATYRËS SURREALE

nga Behar Gjoka

Pjesë e vler të krijimtarisë letrare, të gjerë dhe përplot larmi të **Martin Camajt** është edhe dramaturgjia, madje ajo shënon edhe njërën prej shenjave letrare më impresionuese, gati e harruar prej historiografisë së shqipes në të gjithë hapësirat e ligjërimit të saj. Nga lëmi i dramatikës, interesante në mesazhe dhe imazhe, në figura dhe shprehësi letrare, në replika dhe meditime, të shkruar prej tij trashëgohen vetëm dy tekste letrare, përkatësisht dramat *Lojë mbasdreke* dhe *Kandilja e argjandit*, ku edhe prekim aftësitë shkrimore në këtë gjini, në strukturim, dialog dhe veprim të personazheve, mbase këto shenojnë edhe një tip drame kualitative dhe të ndryshme, jo fort të shpeshtë në letrat shqipe. Këto dy vepra dramatike, në thelbin e vetë sendërtues të dialogut dhe veprimit, skenave dhe imazhit që përcjellin, personazheve dhe skenave, përmbushin dhe shpërfaqin edhe një aspekt të rëndësishëm të korpusit letrar të shkrimtarit, tashmë ato dy vepra të mirëfillta dramtike, do të duhen vështruar dhe shqyrtuar në të gjithë shpërfaqjen e vetë të frymës, mesazheve, teknikës shkrimore dhe të shprehësisë letrare, skicimit dhe plazmimit të pëersonazheve, për të prekur vlerat e pranishme, si dhe për t'i vendosur ato më kontekstin e veprës së gjerë letrare të autorit, por edhe të dramatikës së shqipes, përgjithësisht, veçmas të asaj bashkëkohore. Vlerësimi i kësaj ane artistike të **Camajt**, pothuajse të munguar dhe të heshtur nëpër trajtimet studimore të shqipes dhe më gjerë se sa kaq, por të prekshme dhe me shenja të dukshme në kuptimin letrar në këto dy tekste, luan rol parësor për të fokusuar në të gjitha planet e përfaqësimit autorin, si dhe për të përforcuar idenë se letrat shqipe në lëmin e dramaturgjisë nuk janë krejt të zbehta, siç edhe vijon të kundrohen dhe interpretohen, pa u thelluar në të gjitha vatrat nga ana e historiografisë së shqipes, duke vijuar lënien jashtë shqyrtimit dhe vlerësimit të krijimtarisë dramatike të **Kasëm Trebeshinës**, **Anton Pashkut**, **Teki Dervishit** etj. , çka e bën veprën e **Martin Camajt** edhe në fushën dramtike më shumë se sa një ishull i pa zbuluar.

ANKTHI I TMERRIT PAFUND

Drama e parë e autorit, e titulluar *Lojë mbasdreke*, mbase më e fuqishmja në kuptimin letrar, si skena dhe kolizion dramatik, si figurim dhe plasim i protagonistëve, hapet me një vdekje të radhës. Një ndarje nga jeta, siç ngjet rëndomë në jetën tonë, e dikujt që bëhet shkak dhe shkas për të ndezur fitilat e gjakmarrjes dhe hakmarrjes, e tmerrit të pafund dhe shkatërrimtar, që i ka rropusur supet dhe fatin e shqiptarëve. I ndjeri, ai që ka ikur tek të shumtit, gjithnjë si parathënie tekstuale dhe ndërtekstuale, në formën e amanetit tronditës e kishte lënë me fjalë, që në drekën e përcjelljes së tij të shtrohej gosti me mish dhe raki. Një shaka apo lojë e hollë. Një lajmtim tronditës i asaj që pritet të ngjasë. Në ato anë as ishte parë, e as i shte dëgjuar ky reng dhe mallkim i frikshëm. Fjala, fjalë, e fjala bren eshtra. Fjalën e amanetit s'e tret as dheu, dhe prandaj ky kob e makth i papamë përmbushet me pikë e me presje, pa asnjë mëdyshje. Fill e mbas drekës së hatashme, ku derdhet rakia me shtamba e hahet mishi me duar, ndodhi përplasja e zezë, përplasja vdektare, mes të ftuarve të asaj mordje përtallëse. Pas replikave të ashpra, të vrazhda deri në mahi, të hidhura më zi se vdekja, të pranishmit vrapojnë për tek armët, siç ngjet zakonisht në trojet tona, në jug e veri. Hataja e zezë e krismave, pa një e pa dy, në dekim fshiu, sikur të mos kishin qenë, nga faqja e dheut plot njëzet e katër burra. Gjama, ma e zeza e shoqeve të para dhe dëguara këtyre anëve, që i kapërcen natyrshëm kufijtë e normales. Gjama, ky tmerr që ka vu në rrezik jetën dhe vetë ekzistencën e fisit arbënor, tashma e mbulojë më gjak krejt oborrin dhe tanë malësinë, duke ravizuar gjurmët e tmerrit dhe të frigës ndër sy dhe ashtet e malësorëve të paepun, në mote dhe shekuj. Qysh prej asaj kohe, të largët dhe të frikshme, të pakohë dhe pa grimën e dritës, atyre anëve, por edhe tjetërkund në atdhe, ka vijuar pa e prishur terezinë e vetë makthi pesëdhjetëvjeçar i vrasjeve makabër, i cili ka patur në thelb hakmarrjen e asaj ndërkohje të zezë dhe të frikshme. Thirrja e gjakut, një

thirrje tronditëse dhe ndjellakob, e gjakut të derdhur në kaq mote, e gjakut që ka lidhjur dhe përçarë gjithë botën, gjakun e të parëve dhe të mbramëve të njerëzisë, të shuar dhe fshirë nga faqja e dheut, aq përdhunisht aty në atë drekë zezonë, ndez sherrin dhe zemëratën e gjenisë së rritur, nëpër vite dhe shekuj, madje duke e çuar njeriun deri na cakun e mbijetesës, nën ethet përvëluese të përgjakjes së zakonit që ka ngjarë dhe po ngjet ende në këto troje, të vrarë dhe plaguar pa mëshirë.

LOJA ME JETËN

Në cakun e tmerrit dhe territ të syve të shpëritit dhe mendjes, të fikjes së shpresës dhe besimit se edhe mund të dilet prej kasapëhanes, kur janë hedhur pesëdhjetë vitet mbas krahëve, duket si shaka dhe mahi, madj më tepër si një lodërtim i pavend, bashkë me ndodhinë e tmerrshme, ku shuhet jeta njezet e katër vetave, të përfshirë qysh më përpara në përvëlimën e gjakut, në skenë futet lojë e trefishtë:

A - Loja e të vetmit dëshmitar, mbase edhe shkaktarit kryesor të tragjedisë së hidhur, të asaj ngjarje tronditëse dhe tepër të largët, e Zekës, burrit të pathyshëm që mori shumë plagë, por edhe që vrau aq sa deshti, i cili është edhe heroit qëndror i dramës së parë të autorit. Ai, burrë i frikshëm dhe dredharak, pasi ka heshtur nëpër kaq e kaq mote, mbase ka heshtur duke folur me vete në jermi të plotë dhe krejt të hatshme, pasi i ka zhdredhurar të vërtetës së hidhur dhe ndëshkimit të merituar, mbi fillimin e tmerrit dhe të zezonës, më tepër për lojë ose shaka, si për t'u përrallë ai burrë i pathyeshëm, trim dhe dinak, zë e ia zbulon petët lakrorit, krejt pa vetëdije dhe me një krenari naive. E vërteta e njëmendtë, e largët dhe e tmerrshme, frikëndjellëse dhe rrezbitëse, e mbushur me ankth dhe lebeti, me shpresën dhe besimin e kotë se do të shuhej zhurma e saj, por ajo del në shesh, pikërisht në ditën për diell, madje në mënyrën më të lehtë të mundshme.

B - Ideuesi dhe realizuesi i lojës së mbrapshtë, që ia rrënon shpirtin heroit kryesor, por edhe personazheve të tjerë të dramës dhe të ndodhisë, është avokati më i ri, që nëpërmjet kësaj ndodhie të çuditshme dhe shkatërrimtare, pra zbardhjes së saj, dëshiron të mbrojë doktoranturën në drejtësi. Ai, si askush tjetër, në fakt i hyn lojës me ndershmëri dhe përkushtim, pa asnjë paramendim dhe prapamendim të keq, vetëmsa të zbulojë të vërtetën e kaq shumë viteve



të lëna mbas krahësh, të fsheur me mjeshtëri, të vërtetën e tmerrshme që fshiu nga faqja e dheut për një minut njëzet e katër njerëz. Në këto raste dihet fillimi, mbase më saktë tmerrri i fillimit, por se si mbaron ngjarja apo gjama do të që më mirë të emërtohej, me të gjitha përmasat dhe rezultatet, ngjyrat dhe shprehësinë mbetet engimë dhe pezull, gjatë gjithë veprimit dramatik të kësaj pjese. Pikërisht, mbarimi ose fundi i heroit qëndror, në këtë formë e jo ndryshe, i mvesh dramës nota të theksuara tragjike, herë-herë të ngjyresave të mëdyshjes dhe tmerrit makbethian, sidomos kjo ndjesi bëhet e prekshme prej fundit të papritur dhe tejet rrezbitës.

C - Pjesë e kësaj loje, vrastare dhe verifikuese, të butë dhe rrënuese, me dëshirë dhe vetëshkatërruese, bëhet edhe gjyqtari, mjeku dhe kasapi, tre prej personazheve të rëndësishëm dhe kyç në zjhvillimin e ngjarjeve dhe të ecjes përpara të veprimit dhe situatave dramatike. Ndryshe nga avokati, që po luan realisht lojë, madje prej saj ai po dle edhe më i fituemi, sepse tashmë ia ka falur gjakun e gjyshit të vetë, ndërsa tre personazhet e tjerë, që bartin edhe shenjat e dikurshme të ndodhisë makabër, e kanë marrë kaq seriozisht sa jo vetëm se duan të bajnë detyrën, por më tepër se duan që t'i tregojnë vendin njëherë e përgjithmonë Zekës, kaposhit të malësisë, trimit të përmendun në ato anë edhe në këngë, i cili nuk e ka ulun kryet kurraj dhe në asnjë rrethanë. Seroiziteti i këtyre të fundit, real dhe i përjetuar me të vërtetë, një dëshirë e çmendur, në shumicën e sekuecave të dramës, të pjesëve dhe pamjeve të renditura në atë mënyrë shpalimi të njëtrajtshme, si dhe të materies tekstologjike dhe të sekuecave dramatike, aq të pasur në ngjyresa ligjërimore dhe frazeologji, ku edhe shpërfaqen dhe portretizohen realisht karakteret më kryesorë të kësaj drame, nga më tronditëset në letrat shqipe bashkëkohore. Mbase loja e tyre, një lojë absurde gjithsesi, e marrë pikërisht me atë lloji serioziteti dhe detyrimi, me atë lloj vlerësimi dhe përjetimi, jo si lojë dhe shaka, po si një veprim real dhe i mirëmenduar, bëhet shkaku i vetëm, mbase gjasa e pashmëngshme, për ta dërrmuar dhe zbuluar në të gjitha dritëhijet protagonistin e veprës, e për pasojë edhe personazhet e tjerë të dramsë, të cilët janë funksion dhe variabël i personazhit qëndror, madje duke i dhënë dramës kështu edhe një ngjyrim të pastër surreal, që ka mundësuar shpërfaqjen e një realitetit letrar të mëvetësishëm dhe të dallueshëm nga ajo çfarë kemi parë të paraqitet, përgjithësisht në artin e shërbesës jashtëletrare, që në fakt e vonon përfshirjen dhe pikëprputhjen e letrave shqipe, sa më shpejt që të jetë e mundur, në shtjellat letrare bashkëkohore, sepse aty e ka vendin. Prania e këtyre formave të lojës, natyrisht të lojës dramatike dhe komike, tragjike dhe heroike, natyrisht të një heroike të marrë, e shpërndërron kështu veprimin dramatik, sekuecat dhe replikat e shëkmbyera ndërmjet personazheve, kryesorë dhe episodikë, madje në një gjendje të beftë dhe marramandëse, aq sa realiteti konkret tjetërsohet në një situatë impresionuese, e cila të zgjon imazhe të paimagjinueshme.

PARATHËNIA AUTORIALE E RRËSHKATËS

Në krye të dramës së parë të shkrimtarit, mbase do t'i qëndronte për shtati më mirë titullimi i saj si dramë e gjakmarrjes, nëse mund të emërtohet kështu po të nisësh kryesisht nga motivi dhe ndodhia kryesore dramatike, e cila shpërfq gjamnë që shkatërron qenien njerëzore gjer në pakohësi, pikërisht këtu qëndron edhe një tekst autorial, i cili bashkëshoqëron dhe shpërfaq edhe tekstin dramatik, madje si një situatë e tjetërfarshme, krahasuar me dramtikën e shërbesës së socrealizmit, e cila rrezatonte linjën *bardhë e zi*, ndonëse edhe këtë ngjyrim, me tëpër e ndeshim pa përdorur vijën e pasur spektrale të këtij ngjyrimi kontrastues. Vlerat e dukshme dhe thelbësore, si art dhe shprehësi letrare, të këtij teksti, nga më tronditësit në dramtikën e shqipes bashkëkohore, që realisht kryen edhe funksionin e një parateksti brenda tekstit dramtik, lidhen ngushtas dhe qëllimisht, së paku me dy aspekte:

Së pari: Me ritregimin e fabulës së veprës, me një formë sa më të shkurtër dhe të thjeshtëzuar, si për të tërhequr vëmendjen e lexuesit apo të spektatorit të teatrit mbi nodhitë e frikshme dhe rezonuese edhe sot e gjithë ditën në jetën shqiptare, madje në hollësi dhe detaje të plota, në një distancë të tillë të barazlorguar nga koha reale e ngjarjes, dhe të vetëmjaftueshme, që kryen funksionin e një parateksti letrar shpëgues, të tekstit kryesor të dramës.

Së dyti: Zbulesa e autorit, një shpërfaqje e beftë dhe e domosdoshme, po të nisësh nga fakti që ai ka mëtuar që me çdo kusht dhe me çdo çmim do të duhet të rrisë ndikensë mbi faktorët që kanë diçka ne dorë për të ndikuar sadopak mbi realitetit e frikshëm që ka krijuar gjakmarrja në mjediset tonma, çka në fakt nuk ngjet shpesh në gjininë dramatike, sepse vetë situata dhe dialogimi, veprimet dhe

replikat e nxehta të personazheve, gati e pamundësojnë këtë shans dhe mundësi, ku ky artikulum zbulues dhe artikules të shkrimtarit, na vjen si një prani e shpallur dhe e domosdoshme për të sqaruar ngjarjet e dramës, si dhe për të përndritur vetjet e saj, pra personazhet e dramës. Parathënia e konceptuar kështu, madje mjeshtërisht nga autorit, në një situatë të pastër parateksti, që edhe paralajmëron dhe skicon pamjet që do të shpërfaqen në tekstin dramtik, si për të sqaruar kryesisht dhe enkas rrjedhën e ngjarjeve, madje në të dyja kohët, si kur ndodh vrasja e hatashme, në atë drekë mortore dhe tromnditëse, edhe tani kur po rrëmohet për t'u mësuar e vërteta e saj, e vërteta lakuriqe dhe pa shansin për ta mbuluar *diellin me shoshë*, siç shprehet shumë qartë populli, mbase edhe të personazheve qëndrorë dhe episodikë, si tipare dhe veti përgjithësuese, si përfaqësim dhe karaktere të spikatura, të mjedisit dhe të kohës reale, kur edhe kanë ngjarë tmerret e frikshme, shërben në këtë rast edhe si element i mirëfilltë ritregonjës i ndodhisë dramatike, mbase fabulor i veprimit dramtik, e cila do të shpërfaqet nëpër pjesët dhe pamjet e dramës, përmes dialogut dhe veprimeve të figurave të pranishme, qëndrore dhe dytësore të kësaj drame, moderne në thelbin e vet sendërtues.

STRUKTURA KOMPOZICIONALE E DRAMËS

Ndarja e dramës, së gjakut dhe gjakmarrjes, në pjesë më të vogla përbërëse, saktësisht në dy të këtilla, mjaft të mëdha dhe funksionale, në shpërfaqjen tërësore është realizaura sipas parimit klasik, duke përfshirë në të prologun dhe epilogun, pra hapjen dhe mbylljen e dramës, që kanë peshë dhe rol parësor për ta sendërtuar atë poltësisht në këtë pamje dhe nivel realizimi, si dhe me ndarjen në pjesë kryesore të veprës. Prologu i dramës, si një pasqyrë parake e materies letrare të dramës, mjaft i ngjeshur si skenë dhe sekuenca dialogimi, paraqet qartësisht një mjedis familjar, ku dy protagonistët, pra burri dhe gruaja, kryesorë të veprës zbulojnë ankthin e ngjarjes së përpara pesëdhjetë viteve. Zeka dhe Bjeshka, dy bashkëshortët e çuditshëm dhe të lumtur sa nuk rrëfëhet, dy dëshmitarët real dhe hipotetik të asaj gjama, dy njerëzit kyç dhe mbulues të ndodhisë së tmerrshme, natyrisht me bisedimin hidh e prit ndërmjet tyre, por të shoqëruar edhe më ngjyresa ligjërimi, të dyzuar dhe të dyfishtë, të fshehjes së të vërtetës së dikurshme, por edhe të tanishme, në kuptimin e prekjes së saj, pikërisht në plagën ku edhe dhemb më shumë, si padashje në llafogjemat e tyre, ata ia heqin petët lakrorit të përgjakur, asaj drekës së hidhur dhe tronditëse ku humbën jetën njëzet e katër vetë, dhe ku mori dhjetëra plagë edhe Zeka, heroi qëndror i dramës. Pjesa e parë, e cila bart edhe peshën kryesore të veprimit dramtik, si dhe më e gjata e dramës, zë fill me dukën (pamjen) e parë të veprës, e cila sendërton dhe shpërfaq pikën e lidhjes, që realisht përkon me shfaqjen e Gjormit, një personazh simpatik dhe imagjinar, që bart më së shumti idealin dhe qëllimësinë e autorit, në shpresën dhe besimin e gjetjes së të vërtetës, më dëshirën e mirë për t'i prekur dhe zbardhur ndodhtitë e hershme, të cilit në atë drekë të hatshme, të mbytyr në gjak dhe raki, të mortit të shakaxhiut të malësisë, i kanë vlarë gjyshin, pra një ta afërmë. Ai, tashmë është bërë burr dhe avokat i ri, dhe nëpërmejt asaj ndodhie dëshiron të mbrojë titullin e doktorit ne drejtësi, pra si një njeri që ka pësuar ndryshime dhe përmbyyje të prekshme, madje të jashtëzakonshme në raport me krahinën dhe mantalitetin e saj. Në dukën tjetër ose tek pamja në vazhdim, rishtas vijon paraqitja më e thelluar e kolizionit dramatik, pra e përplasjes së mendësisë së trajtimit të asaj ndodhisë së hershme, të ndodhisë që mban peng dhe të shqetësuar edhe këtë kohë, edhe këta pasardhës, e cila shakton njëzet e katër të vdekur, që shpërfaqet e plotë dhe me ngjyresa të papritura në dialogun midis Gjormit dhe Bjeshkës, gruas së Zekës. Këto episode, veçmas të tjerave, të dy pamjeve të para të dramës, si me thënë ma qartë edhe parapërgadisin ardhjen e heroit kryesor të dramës, Zekës, në dukën e tretë, heroit më të shumëfishtë dhe më të plotë të veprës, i cili bart dhe na e shpalos edhe psikologjinë, mentalitetin dhe gjurmët e së kaluarës, si një plagë e pambyllur ende, por njëherit dhe përngjitasi me të, edhe të mosnënshtimit si burrë dhe njeri, pra të mos ndryshimit në kushtet e reja, që vevetiu do të duhej të përçonin tek ai lëvizje natyrale. Tek ky fragment, zezona e hidhur dhe tmerrri i parrëfyer, pra ndodhia e largët si kohë reale, nis që të afrohet dhe të ndikojë ngjarjet e dramës me shpejtësi rrufeje. Replikat ndërmjet Bjeshkës dhe Zekës, dy personazhet qëndrore të veprës, këtu, pra sidomos në këtë dukë e japin qartësisht shqetësimin për shfaqjen e kësaj ndodhie. Duka e radhës, kuëptohet pamje tjetër e dramës, shënon një rritje të gradacionit dramatik dhe shprehës, të veprimit dhe shprehësisë letrare, në fromatimin dhe shpërfaqjen e kolizionit dramatik. Zeka dhe Mjeku, ky i



fundit një personazh tjetër i veprës, madje nga më interesantit e dramës, shkëmbejnë midis tyre fjalë me dy kuptime dhe nënkuptime, shkëmbejnë replika të nxehta midis tyre, si për të njoftuar se ndërgjegjja e secilit prej këtyre personazheve vlon dhe zatetet në pabesim të shoshoqshëm. Në këtë dukë, nga më interesantet e dramës **Lojë mbase dreke**, konturohet mjaft qartë edhe atmosfera e vendit, dokeve dhe tipareve që gdhendin deri në skalitje ato në figurimin e personazheve dhe të gjitha mjedisit përqark, ku edhe luhen ngjarjet. Pikërisht, në këtë sekuençë dramatike, me ngjyra dhe tone tragjike, këtu na zbulohet edhe një idil familjar i papritur, megjithatë i rrezikuar prej hijeve të ndodhisë së dikurshme, që tashmë pret të rindizet rishtas. Në veprimin dramatik të këtij teksti, futen edhe dy personazhe të tjerë, gjyqtari dhe kasapi, dy figura me peshë specifike të ndjeshme në këtë dramë, ku i pari, pra gjyqtari që përfaqëson ligjin dhe shtetin, drejtësinë dhe format e saj, ka peshën dhe rolin e protagonistit në të dy pjesët e dramës. Episodet e pjesës së parë të dramës, një pjesë që në fakt zbulon ankthin dhe tmerrin e protagonistëve, pra një gjendje aspak e këndshme dhe normale, shpalosin karakteret në të gjithë diagramën e vetë, por edhe në funksion të ngjarjes së hershme, të asaj ndodhie tmerrri dhe makabriteti, tashmë të rimarrë për të riformuluar artistikisht vetë ngjarjen, veprimet dhe dialogun, protagonistët dhe pasardhësit e tyre, mbase vetë veprën letrare, më situatën e replikave dhe të veprimit dramtik, tanimë si dy prej elementëve thelbësor dhe më kryesor të plazmimit të personazheve në një vepër të mirëfilltë dramatike. Në pjesën e dytë të dramës, ku edhe merr udhë zgjidhja e konfliktit qëndror dramatik, pikërisht

në dukën e parë të saj, aty ku zë dhe zbulohen gjurmët e para të shkokëllimit të vetëdijes së personazheve, në kuptimin letrar dhe të kolizionit dramatik, rrjedha e ngjarjeve merr një kthesë të papritur dhe krejt të tendosur, në dhënie e ngjarjeve dhe në skicimin e personazheve. Prania e lojës, natyrisht e lojës së ndërfutur në tekst, e lojës dramatike dhe komike, pra e shakasë së hollë, e shkasë ploteë mençuri dhe dije, e shpërndërron veprimin dhe sekuenat e veprës në ngjyime tragjikomike, madje të një tragjikomizmi rrëngqethës në shumciën e dukjes së vet. Pra, tani e mbrapa, skenat dhe dukjet, dëshmojnë se kemi një vepër dramatike ku përzihen dhe gërshetohen ngjyresat dramatike me tonet e pastra komike. Në dukën e dytë të kësaj pjese shpërfaqen edhe dy elementë kryesorë, që i japin ndodhisë së veprës një rrjedhë të ndryshme, madje krejt të tjetërsojshme. Nga njëra anë gjyqi i merituar për Zekën, dëshmitarin e hershëm dhe të vetmin e atyre të shituarve, që ka shpëtuar nga kasaphana e askohshme, tanimë është shndërruar në një lojë, çmendurake dhe frikësjellëse, e në këtë çast çdo fije e ngjarjes, makar odo fjalë e ligjëruar, aq shkujdeshëm dhe në ekzazhën e tjetërsimit, ndihmon për ta shpërfaqur qartë e më qartë fajninë e dorasit, fajin e kryer me guzim dhe vetëdije, por ta pazbuluar ende të këtij burri të paepur. Në anën tjetër, një situatë e beftë që çapon hapat e të parit, e shpaluar në një linjë paralele, gjitnjë në pritje të lojës që do të shkaktonte të qeshura, ndodh zbulesa e konfliktit në të gjithë përmasën e vetë, na përmasën e kimit të hidhur dhe harrimit prej kohës së gjatë, por edhe hapja e fundit të barkut, pra zbulimi i të vërtetës në shesh të burrave, tashmë të secilit personazh të dramës. Në këtë hallakamë tmerrri dhe ankthi të (pa)merituar, për të qarë e për të qeshur, madje për të provuar dhe shijuar gjendje tmerrri dhe frike, për të pritur më kot që të shfaqet vrasja e ndërgjegjes, natyrisht vrasja e ndërgjegjes së vlarë qysh asaj dite të drekës së mishit dhe rakisë, të drekës mortore, të drekës së shtruar në nderimi të një shakaxhi të tmerrshëm, që edhe në atë botë sundonte dhe mbante peng të gjallët, dëshmitarë të ndodhisë, por edhe pasaqrhdësit e rritur me tonin dhe ngjyresat e asaj dreke të parrëfyeshme, me tonalitet të dukshëm dhe funksional të ndërthurjes së komizmit me tragjizmin, lojës me seriozitetin, shakasë dhe sarkazmës therëse, zbulohet loja e artit për të skicuar artistikisht realitetin letrar, e artit dramtik, të nje sinkretike tragjikomike, më së shumti, në një tekst të ngjyrosur herë-herë me tone të një frazeologjie mençurake, që të ndërmend alegorinë dhe shëmbëllimet orale që aspiron dhe realizon ajo në komunikimet e përditshme. Ky episod, mjaft tronditës dhe domethënës, natyrisht njëra nga dukjet (pamjet), më të gjata të veprës, mbase edhe me peshën më të madhe në pikëpamje të zbulimit dhe zgjidhjes së kolizionit të veprës, të veprimi dhe situatave të larmishme dramatike, sendërgjon kështu edhe pikën kulminante, çastin më domethënës të këtij teksti, pra gjetjen e të vërtetës së tmerrit të provuar fill pas asaj dreke makabër, drekë të mbrapshtë, të mbushur me zi, mish dhe raki, por edhe me një tmerr të paparë, por që e tejkalojë atë kohë, dhe realisht u shtri dhe zgjatua si veprim dhe frymë edhe në kohërat e mëvonshme, të këndeje kohës së mungesë së harrimit të tmerrit të përjetuar. Në këtë dukë (pamje) të përveçme, madje nga më të ngjeshurat dhe të fuqishmet nga ana letrare, madje edhe në pikëpamje skenike, ndodhin njëra pas tjetres shumë gjana të hidhura dhe të tmerrshme, ku mjeku më tepër **shpifet** (sajohet për të marrë hak), si dëshmitar i gjamës së Përronit, shpifet enkas më tepër për të marrë hakun e të atit, që kishte qenë vra në atë ditë të fundme, ndërsa Gjormi, një njeri që pati humbur gjyshin në atë ditë të zezë, në mënyrë të paimagjinueshme dhe ideale, merr në mbrotje Zekën, burrin trim dhe dinak, mbase burrin luan dhe dhelpër, njëherit, të pamposhtur nga asnjë rrethanë dhe bëmë që lidhet më gjakmarrjen, gjithnjë sipas njerëzve të fshatit shkaktari kryesor dhe fajtori i kaspëhanës së asaj mbase dreke, e cila nisi thjesht si lojë dhe shpëjt rrëshqiti në tragjedi të papame, por e vështron dhe e mbron si hije dhe fantazmë. Pikërisht në këtë episod, ekstrem dhe fundor, ku luhet jeta me vdekjen, komedia dhe tragjedia, gazi me vajin, fiket edhe jeta e Zekës, shajnisë kryesore të asaj ngjarje të tmerrshme, burrit të paepur dhe mister, madje fiket befasisht dhe pa dhunë, siç askush nuk e priste që ndodhte kështu. Prandaj, konflikti dramatik aq i rënduar, merr udhën e zgjidhjes krejt papritur, por zgjidhet fundekrye në mënyrë arstistike. Në dukën e fundit të pjesës së dytë të dramës, tashmë skena sundohet vetëm e vetëm nga gjyqtari, që e ka fshirë historinë e mëparshme dhe ka hyrë në hullinë e jetës normale, të gjyqeve të zakonshme dhe krejt të rëndomta. Epilogu, në mënyrën më të dhunshme, si fillim i mbarimit të tmerrit, mbase të tmerrit të merituar, shpalos fundin e Zekës, protagonistit të dramës.

(Vijon në numrin tjetër)

NJË KAMBANË QË KUMBON NË HESHTJE

nga Pirro Lori

Kënga e Solomonit është këngë biblike. Është Kënga e këngëve, ose kënga e dashurisë. Ka mijëra vjet që ecën drejt nesh, drejt çdo çifti të dashuruar.

Dy trupa mish e shpirt, dy buzë të kuqa që puthen, e brishtë me aromë e verëkuqe, romantike e qiellore, por dhe tokësore me luftën për të jetuar e me dramat zakonshme të njeriut. Mirë se vjen Sulamith!

Me këto këngë në buzë erdhi dhe Sadik Bejko te vëllimi i fundit, më kulmori i vlerave të poezisë së tij. Mirë se vjen poet!

Dashurinë dhe femrën Bejko e krahason me forcën e gravitetit. “Ty, e dashur, doja të ta dhuroja sot/sy për sy gjallë e të prekëshme/Këtë Shqipëri të gurit dhe të karafilave.

Por te “Shqipëria e karafilave” simboli i karafilut, i bukurisë e begatisë në vendin tonë i mbetet vetëm dëshirë e parealizuar. Amaneti qenka i rëndë. I zi. Mbushur me mort. Brenga dhe poeti mbajnë njeri tjetrin mbi shpinë.

Karafilat kthehen në krizantema që “vetun vorreve lulzonte”(Mjeda) e: “kjo rrënoqethje erë varri/si ledhatim i ri më ngjet”(Esenini) E Motra e poetit, ajo e mira, fisnikja, e brishta si shpirti qan: “vdekje të zeza burrash, në temtha kyçur/ me tym baroti të nxehtë/ shkrehur nga gëzhoja të nxira”.

Me një krah karafilash mbi varre – ato, ato, – motrat e gratë, nënat e të dashurat tona, rënur në gjunjë mbi baltën e varrit u dridhet tufa e karafilave në duar e bëhen të zinj, të zinj – si nata krizantema mbi varrepor, për poetin, “Brenga mund të pastrojë ajrin e planetit gjer te zemra”. “Këngë të Solomonit” është plot e përplot me këngë të trishtuara Sadiku ka një përvojë të pasur jetësore dhe artistike. Jeta e tij plot zigzake nga mësues në një fshat të humbur tek profesor universiteti te doktor i shkencave filologjike; nga punëtori i minierës deri te deputeti. Ai, mbi të gjitha është poet, e pastaj pedagog e orator i talentuar më zë basi, shkrimtar, studiues, eseist, e së fundi sekretar i përgjithshëm i PEN-it shqiptar.

Është poeti që e shtrydh botën “që krijon” vetë, e banon intensivisht me tërë forcën e ndjenjave përmes një ankthi gjetjesh të papritura plot emocione e mendime origjinale. Është këndi i pjerrët e ekzistencës së një poeti që e di peshën e figurës artistike, asaj përtej përvojës, metaforës që merr trajtën e një qenie unike në thelbin e vet, sa intim, aq prani tjetër për tjetrin. Ky poet është i zymtë, i thellë, i menduar. Një kampanë që kumbon në heshtje e ndonjëherë duket se i njeh të gjithë rrathët e ferrit. Sadiku ka qenë ca vjet nëntokë, (dënuar nga 1973-i) dhe e di mirë baltën dhe terrin e zi të minierës). E njoh hap pas hapi jetën e tij dhe kudo e kurdoherë ka pasur një dritë të brendshme në shpirt. Është poezia shpirti i tij.

BOTA MË PËRTEJ

Së pari Sadik Bejko është mjeshtër i portretizimit. Ai ka syrin e piktorit që zgjedh kë të pikturojë. Ato që nuk i sheh dot ngjyra i shpreh fjala. Dhe ka intuitën të gjejë çka guri në zemër, çka mali e krokodili, e gruaja që dashuron, motra dhe stërgjyshi harruar. Portretet poetik të tij, jo vetëm te ky vëllim, e zgjerojnë botën. Kur lexon diçka nga dimri ke lexuar borën në gjakun e plakut. Dhe fjala e tij i ka të gjitha ngjyrat dhe nuancat (në penel) deri te kapilarët e padukshëm mbi gjethe. Pikturon të bardhën duke shkallëzuar mbi të bardhën, të zezën me më të zezën dhe, krejt asosacionet e fituara me këtë sintaksë të re poetike, e shtynjë njohjen më tej. Kështu portreti poetik i botës shkallë- shkallë a shtresë-shtresë si te pikturat e Rembrantit në relief, duket si i gjallë. E objekti ka marrë emër tjetër. Poeti është buti i tharë i verës, gropa me sytë plot ujë me akull anash, vresht Ai hap gropa. Mbjell ullinj për vaj, rrush për verë. Vresht i vjetër fidanë të rinj. Shihen si fshin vesën e ngrohtë syve.

Dhe ëndërron. Mendon. Dyshon. E përsëri ëndërron. Ndoshta sheh mesnatave që vinë e “rrëmbushet me yje”. Por është dhe njeriu, krejt i përkohshmi. Dhe bëhet prej

drite edhe për një gjest njerëzor, atje ku e priste krahëhapur gruaja, tryeza, shtrati. Një gjest, vetëm një. Sa pak, sa pak duan poetët! E dritëzohet i tëri. Si luleferra, lulebajamja. Një gjest njerëzor. Një. Dhe: Të lindin cunat të përcillen me lule pleqtë Te poezia tjetër “Ikja e bukur”, plaku pas lëngatash, i bukur ngjan tash në vdekje “Me pamje dhëndërrri e djali, anipse “Shtatë grykë të njoma bijash në kor e qanin” e “mbi varr një gështenjë, roje e fortë si gruaja çdo ditë e natë plakut do t’ia lëmojë shtatin e, vazhdimësia e brezit i ngjall të blertat mbi pemë Janë të bukur pleqtë e Sadikut. Ai kërkon mëshirë për dimrin. Është shenjtëria e gjyshit që po ikën.

Me sytë borë e akull. Mëshirë për këta lot. Mes ngrica vdesin Toka këta i pranon me bujari. E rrënja mbetet rrënjë. E bari mungulloi si pushi mbi faqen e çunave, Te “Lamtumirat” - Një tjetër portret madhështor. Një gjetje mbresëlënëse. Rrapi, ashtu i rreptë, një rrap që flet. Me një brengë të madhe në çdo kërcell. Dhimbje burri, e brendshme nëpër damarë, e patreguar. Durimmadh ky burrë, si rrapi. Ikni të gjithë prej meje, thotë. Unë jam rrapi i vjetër që mbetet me sy nën lëkurë nën degë/të shoh kush po ikën tash e parë”. E rrapi zemër madh: Të lumtur për ç’qemë tok në çastin a orën e bardhë”. Prej tij ikin të gjithë. Gjethe, zogj, degë të thara, bryma, bora, shiu- në prill e në maj. Mua këtu më keni. Prej rrënjësh, në gur e në baltë. Le të vijë uragani, të më shkulë nga rrënjët. T’u lë tumirë furtuna të dashura. tumirë qiejt e mi, ajri im, dielli im. Dhe natë. Ama, natë e bardhë. Për burrin e rrapit Poezia “Një vjollcë, ka vetëm pesë vargje. Është fjala që dredhon për atë që do të thotë. Thelbi që nuk duket ndrit si lulevjollcë. Dhe më poshtë nxin si rubin i zi. “Një vjollcë i ka mbirë te shtati e lulëzon gjer në fytyrë”. Vitraina u tha, u pa. Por autori humbtka nëpër renë e saj dhe çudia nuk vazhdon gjatë. Fillon të zbardhet, “në blunë e saj je shaluar”. E pastaj: Shkelmimet, gjësimet, e humbjes/ nëpër qiej / kumbojnë”. Jo pra, jo. Vjollca s’është e tillë. Rendi, po. Pushteti po. Partitë, po. Dhe demokracia në blu shaluar. Dhe ajo i zhgënjën disa. Të parët militantët. Se ky djallo shteti ynë e këto parti të shtrokan edhe për në “Festa” mjaltë të hidhur “Burrnesha” krejt origjinale pena e portit dhe krejt e përveçme drama e saj. Fytyra e saj, tashmë mbuluar me rrudha “rrufitur, rrudhosur, balli, mollëzat gjer në vesh”. Gjarpri e ka shkelur dhe merimanga. Po “syri i kthjellët e shpues, far në hon ferri, yll në hartë humnere” me një monolog tronditës ajo bën dy goditje Një, ndaj vetes (“barbare, primitive”, “ke helm

të helmosh, ke zjarr të vësh flakën, ke dinamit sa hedh në erë galeritë e ferrit”). Dy: ndaj atyre që i thonë, prano që je e tillë; ajo pranon “meqë e thënki ju”. Cilët janë ata që e akuzojnë, e di lexuesi. Para nesh ngrihet portreti i saj. Vini re shkallëzimin mjeshtëror të fjalës së poetit “gozhdë e zezë në fytyrën e kohës”, pus dritëhënor, thëngjill i zi. Dhe më tej: jam burrneshja, shkreptëtimë e shuar, gjeth i rënë mali, e zeza e grykës së pusit, akull, thëngjill në hi seksi shuar. Fajtoje apo viktimë? Fat apo fatalitet i imponuar? Lexuesi mund të ofrojë disa lexime.


PESHA E FJALËS

Poezia e Sadik Bejkos te libri i fundit “Këngët e Solomonit” është kuota më e lartë e vlerave të këtij autori. Kjo poezi është guximi i të pathënës. Lartësimi i fjalës shqipe. Përbrenda saj është aftësia dhe prirja për të heshtur, për të heshtur për gjërat që dihen, për ato që nuk thonë asgjë. Ky poet e percepton poezinë si liri shprehjeje, jo vetëm si harmoni formale, por dhe si një gjetje, si një zbulim në marrëdhënie të tjera. Fjala e tij e zgjedhur triumfon në zgrip të vetvetes. Ajo kumbon dhe e merr dimensionin e saj tej vetvetes, në mosdukje. E fjala artistike, ngjyra, tingulli veç sekreteve brenda gjinisë, karakterizohen nga ajo mjeshtëri artistike dhe ka dy sekrete të mëdha: e para, ta zbulojë sendin që do eksplorojë, e dyta, ta fshehë (Oaze). Poezia e Bejkos duket sikur është krejt një monolog. I ndërgjegjshëm. Ai ëndërron. Ai di. – Të dish, d.m.th., të dyshosh. Kjo është prirje erudicioni në kërkim të vetvetes. Jo vetëm për njeriun gjenetik, jo, por për qenien Poet. Ai e di se duhet ndryshuar statusi i sendeve, dhe brenda përvojës së tij, me guxim merr përsipër riemërimin e gjerave. Nuk është poeti që pozon për t’i pëlqyer dikujt. E veçanërisht masës, ai është një dorë e zgjatur tek tjetri; ai ecën duke kërkuar një copë tokë, një hëhë tjetër, një rreze dielli. Fjala e tij shkon atje ku diçka mungon. Ai e di se çelësi i jetëgjatësisë së poezisë është forma dhe më i drejti kriter e moral i vlerave, është njohja e së keqes.

Koha tek ky poet nuk ka kahje. “Koha shndërrit në ëndërr e kjo do të thotë të dish” (Valery). Gjithmonë dicka i ndodh kohës. Dicka si frakturat. E përgjigjen e saktë e jep vetëm fjala poetike. Kjo poezi e njeh çastin historik. Dhe formën e ka në sallonin e modës. S. Bejko, është nga të rrallët poetë shqiptarë që i ka qëndruar fjalës poetike(vetvetes) pa lëkundje, pa spërdredhje rrethanash. Ai e ka ditur fort mirë se antenat e vlerave poetike drejtohen nga figuracioni i ngjeshur. Mbi bazën e krahasimit Bejko gjen metaforën dhe simbolin më të çuditshëm, të papriturën. Atë që mungon. Gjetja e formës kërkon dhe thellësinë e mendimit, trajtimin enigmatik përmes një sintakse poetike të zhdërvjelltë. Pikërisht këto cilësi të lakmueshme nga poezia moderne, kalojnë në heshtje e shpërfillje nga syri dhe vëmendja e opinioneve masiviste, reklamave, popularitetit fals e festave amatoreske.

Poeti i vërtetë nuk bie në kurthet e bashkohësisë e mediokritetit festiv; nuk noton në ujërave të cekëta, lehtësisht të ndjeshme e të turbullueshme, që nuk mund të bëjnë dot as valëza, pa le dallgë. Fjala te poezia e Sadikut është e zgjedhura e “ustait”. E limuar e kalitur në duar të sigurta. Drejt një sigurie gjithnjë në rritje. Ajo arrin deri te vetvetja e mund të flasë edhe nga guaska në fund të detit, edhe nga zemra e gurit a nga venat e gjethe. Fjala e tij plot larmi, një prurje e heshtur në letërsinë shqipe, drejt thelbeve të pashprehura, ashtu drejt brengave e dallgëve të shpirtit, ashtu e beftë për të krijuar lidhje e semantika të pabesueshme, thërret, ulërin, qesh e qan, ironizon çjerr maska, shënon në lule të ballit të keqen te individi e shoqëria, te vendlindja e atdheu. Kjo është poezi me pak natë. Ajo qëllon edhe të zotin, edhe të dashurën. E vërteta e tij qëndron te detaji. Ai nuk flet me askënd. Ndoshta një trëndafil që u zgjatet të gjithëve. Në heshtje. Fjala e Sadikut, është zonja e rëndë që sfidon të zakonshmen dhe e gjen vendin atje ku metafora shkon drejt absurdit. Është kjo fjala e zgjedhur poetike, që të merr prej dore e të tregon parajsën, rrugëve plot aroma e sende të arta, por dyqanet i gjen të mbyllur; më e sigurt drejt ferrit, tek e errta mbi të erttën, te zbritja a te rënia e njeriut. Gjithsesi fjala poetike nuk kërkon stacion, as adresë, jo, ajo veç ndërton shkallët e nevojshme për ngjitje a zbritje, ajo shtron udhët për te tjetri, e lumi flet, kërthiza lidhet me degën e rrufesë, bryma shpon me gjilpëra, “mosi” te ballkanasi, bëhet “mosi i mosit të mosit” e ulërima shket rrafsh pyllit me brymë; fjala e tij të qep mbyllur në gjethe dhe bota me një figuracion të tillë, zgjerohet dhe merr emër tjetër. Poezia e Bejkos është solide. Nuk është fjala vetëm për ritmin, rimën, kompozicionin, simetrinë a asimetrinë, figuracionin në tërësi, por, për të gjithë elementet e ndjeshmërisë, që i rezistojnë harresës, pra, krejt unitetin e brendshëm të poezisë. Në penën e poetit

SADIK BEJKO





shqipja jonë lartësohet e pasurohet duke dëshmuar mundësi të larmishme shprehjeje, sintaksë të pasur poetike; atje te fjala e rrallë, te lidhja e re me fjalën tjetër, te kompleksi semantik, te ngjitja e simbolit në absurd, deri te neologjizma si pasuri leksimore, si: përhimje, tumirë, curgoj, rrëmbush, terrim, udhështetur, gavror, krisë, sosurë, zgabërojtash e parë.etj. Është pikërisht kompleksi poetik që poeti rritet brenda tjetrit për të parë e zbuluar gjërat që duam. Poezia e tij është për ata që dinë të lexojnë.

AJO, FORCA E GRAVITETIT

Është dashuria, është gruaja. Ajo, nëna, motra, femra – ajo dashuria – tematika më e gjerë e të gjithë poetëve në botë. “E gjithë bota vjen nga sytë e tu të pastër / dhe gjaku im rrjedh në ato shikime”(Pesoa) Emri i saj është puthje në sy. Te “Këngë të Solomonit”, që në faqen e parë, Bejko e krahason me forcën e gravitetit. Ajo rrotullon planetët e pastaj zbret nga lartësitë e kozmosit në: “zgjuar vështrimi im rreh të cekë sytë e tu”. Për te gruaja (dashuria) asgjë nuk e ndalon, as pritja, as nata, as akulli në Arktik. Dhe vetë Zotin po ta kesh, “pa ty dashuri nuk je asgjë” Femrën e do si arusha e uritur hojin me mjalhtë. Për Zotin, nuk di pse Zoti e quaji si mëkat veprën e tij më të bukur. (!), (13;13) e përpiloi kodin penal për njerëzimin. Vetë Zoti është dashuri, ndoshta vetë jeta, e Bibla si kryelibër, është “Kënga e këngëve”. Ose metaforë. Poeti këmbëngul përtej Evës mëkatore “Qiri kolonë flake, ndezur në diell. Dy trupa harkuar një mbi një jam asgjë pa ty dashuri“Kleopatra ime” dhe Kënga e Solomonit” janë dy poema të vogla por madhështore në formë e mesazh – e pa ndrojë – them se, mund të kenë një vend nderi në ballorin e poezisë shqipe. E para: Fjala që ngre monumentin me emrin “dashuri”. Ajo, gruaja, mund të jetë Kleopatra historike e Cezarit a Mark Antonit, por dhe kleopatrat tona, pse jo. Është e kudondodhura, në çdo qelizë të jetës – gruaja – në

pushtet e padukura, oaz në shkretëtirë, – ajo mbretëresha, mjalti dhe kobra “fshehur nën dy thimtha gjarpri a a nën dy gjethe fiku”. “Dhe qumështi thellë te shegët e cicave nën dy sumbulla gjiri”. Pastaj befasisht: Kobra më je ti, zemra ime- e vezullimtë bie ora, bie ora. Ikim. Vdesim. Medet. Nuk do jesh më bijë Mesdheu syftohtë. Pak verë, pak ajër, pak gjuhë gjarpri, pak qiell helmi, në kokërr fiku ëmbël kyçur”. Po po e tëra, plotësuar helmi dhe mjalti, engjëlli dhe kobra. E ja kështu, na thotë poeti ajo mund të jetë busull për Cezar e Mark Anon, por dhe imja a jotja, gruaja, zemra ime që shpall mëngezet e argjendta e rrotullon planetët.

LIBRI

“Kënga e Solomonit” që mban dhe titullin e librit tingëllon akoma më kozmike dhe, sa të ketë jetë njeriu do jetë gjithnjë aktuale. Po vjen ajo, Sulamithi. E dashura. Ka 3000 vjetë që udhëton e tani po e pret poeti me krahë hapur. Dhe unë, dhe ti. Ajo është dashuria vetë, kryevepra e “Kënga e Këngëve”, zbritur nga Bibla, (supozohet e shkruar nga Solomoni). Mirë se erdhe Sulamith! Gjithnjë e freskët, e ringjallur. Ajo, e brishta si aromë, e tmerrshmja si ushtri. Vini re absurdin hiperbolik: “Si një ujkoni që meshkujt i gëlltit/i bën mollë për gjirin/ i bën argjend për shkëmbinj”. “Mirë se erdhe maleve dhe valtheve, ujrave dhe zalleve/Trëndafile e brishtë erdhe sot me emër tjetër, erdhe te zemra e zemrave me emrin dashuri; trëndafil e qiri që digjet në krahët e mi, trëndafile e dritës Sulamith. Tani që nata ra më verbohen sytë, më lbyren llërët, supet, këmbët e tua më ngulen në sy/Tërësi, ngrohtësi, avull e fildishe të dy, në lumin lëkurëhollë të kësaj nate lëvrijnë, lëbyren, zhyten/Oh, oh! Sonte e dua terrin të ndezur me shpatat e diellin në mish. Është ajo, burim jete e njeriu me zemër në dorë(poeti) thërret: Dil, shfaqu ngjyrave, pa rënë në natë; lermë të të shoh siç je, sa pavdekur sytë. Si një sandalle shqyer nga rëra Por poeti vigjëlon dhe në dashuri.

Bejko këtu shfaqet më purist se puristët. Seç ka një brengë e pa na i thënë ne, ia thotë asaj. “Mos më tako për ditë, as nesër, e pasnesër, as pas një viti e një shekulli.(!)- “takomë kur të jesh vetvetja. Vetëm e për veten tënde pa kohë pa hapësirë, pa asnjë prani tjetër mes nesh, qoftë dhe sa një qime floku/ Është drama e jetës kjo. Brengat janë subjektive. Dashuria e singertë kërkonka vetëdije absolute. Ka dhe maska. Dhe hipokrizi. Pavarësia absolute është e pamundur. Tapitë mashkullore kanë ardhur duke u zhvleftësuar. Të paluajtshme në banalitetet e tregut(si sot) Puristi solomon i përmbahet perceptimit hyjnor të dashurisë. Plot hire. Dhe poeti. E mesazhi ikën nga poeti, nga unë e nga ti e bëhet kozmik, i përjetshëm pa pikëpyetje ; ajo, ashtu e bukur përmbi dallgë, përmbi re, përndritëse përmbi yj sikundër na thërret që nga kopshti i Edenit Eva e parë që guxoi jetën e zbriti në tokë si mollë e ndalueme. Pa mëkat. E cili individ nuk do të donte ta kish të tillën? E ajo vazhdimisht në çdo kohë ka vetëm një këngë në gojë: E shihni? Më shihni? Bukur. E bukur jam. Lumtur, e lumtur jam. Vetëm në dashuri jam. E atje bëhem më e bukur.

BRENGA

Është tipar dallues i këtij poeti. Krejt gjoksi i tij është i mbushur me poezinë e dhimbjes. Është gurëzuar si gungë, i mblidhet në fyt dhe e djeg. Qenka e domosdoshme “si bleta hap dhomëza të holla sa hojet, vë dritë, zemrën e mbetur të orëve nga e para e kurdis” Këtë gungë në gjoks të poetit e shoh jo vetëm te poezia “Brenga”, por tej e përtej krijimtarisë së tij shumë të pasur [Vetëm në poezi ai ka botuar : Rrënjët, 1972, Ku e ka folenë bilbili, 1982, Si vdes gruri 1994, Letër Hamurabit, 1997, Somnambl, 2002, Lulekumbullat, (poezi përkthyer nga Konfuci)2002, Psalm për atin, 2003, Perëndim me pak natë,(poezi të zgjedhura), 2004, Fytyrë e panjohur, 2005 Poezi (shqip dhe maqedonisht), botim i Shoqatës së shkrimtarëve të Maqedonisë, Shkup 2010, Këngë të Solomonit, 2017. Është përkthyer në disa gjuhë e si poet ka marrë çmime kombëtare (Penda e Argjendte, 1998) dhe çmime të tjera rajonale.]. Poezia e tij është dhimbje dhe revoltë e heshtur. Nuk del rrugëve për përmbysje por vjen e trashet e bëhet gungë në gjoksin e poetit. E krahas saj, e pas saj, lexuesi njeh një lirizëm origjinal, një violinë që qan. Ndoshta kërkon ta mbjellë zemrën tek tjetri. Dhe zgjatet si puthje. Dhe bleron si pemë. Pa ndrojë mund të them se Sadik Bejko është poet i brengës, Një zë i veçantë që kumbon në heshtje. Në penën e poetit kjo thith pluhurat nga tunelet e territ, diell që shkrin netët e ngricave”. Poeti e gjen pozicionin e vet. Te “Pylli dhe lakuriqi i natës” shkruan se kjo botë, pyll pa ajër, pa gjethe pa zogj e pa çerdhe – përumbje terr as trajta as njerëz E poeti në vetmi e di, “më e mira: rrënjë në tokë se sa dega sipër/po flete me gjarpër zgjohesh me dhelpër dhe fillikat”. Te poezia “Letër mikut të mërguar” malli për vendlindjen është kthyer në një brengë që të djeg shpirtin, rrepet ulërijnë si gojë demashbraktisje tej e tej e ai gjarpri i vendlindjes kafshon, e djemtë na ikin në moskthime, ndonjë plakë e vetmuar sjell në qytet ndonjë tufë bari me aromë, ku fshihet një cipëz qielli që nuk e shohim Nuk është “Thirrja e udhës” është ulërima e ikjes së verbër drejt lirisë e fatit të errët, dorëzimi i kokës së prerë, molla e pjekur këputur me gjithë degë, grykat lart, poshtë humnerë; është fati, fati ynë, fati “Zgjatëm kërthizën, tërkuzën e djepit tonë /e lidhëm në rrufe, në rreze dielli që ther,/ e lamë pas si shtizë të tendosur/te një urë varur, harkuar në ylber”.

NË VEND TË EPILOGUT

Poezia e Bejkos mbart një shigjetë që godet qiellin, pse ai nuk është i kaltër. Te “Ujku” metafora e tij godet edhe genin e vet, ADN-në. Ai “vë kujën jam unë ujku tani Si ati a gjysh, dhe unë, dhe im bir apo ai që vjen më pas “ulërin”. Tani ujku është ai. Egërsi gjenetike kjo ulërimë. E pse jo? Ndoshta dhe krenari, guxim, egërsi, aventurë, bukuri e egër, brez pas brezi kështu. Te “Uria e keqe” (monologu i lumit) poeti flet me vete. Si lumi. Dhe si lumi e ka urinë të keqe. Ha dhera, gurë e shkëmbinj. Dhe brinjët i epen gjer në krisë. Shpatullat e buta i ka prej dallge. Se dhe balta (që ha) dhe gurët dhe bregu i betonohen në cdo hap. Është i brishtë poeti Me buzët e lumit qepur nga shkuma. Po ka uri. Uri. Të egër. Të thellë. Sflitëse. Si lubi. I ziu lumë (lexo, i ziu poet) nuk e mund do bregun e ashpër. Dhe si Krishti e mbart buzëqeshjen e urisë, atë dhimbjen therëse mbi shpinë. Brengën. Ashtu të rëndë si gurë e shkëmbinj. Dhe Flet me vete. Dhe ecën kokëlart për në det. Se vetëm deti e njeh urinë e lumit. Si koha që rrjedh e vonon vlerësimin e vërtetë të poetit. Po Sadik Bejko mund të kujtojë Czeslav Milosz-in dhe atë mërmërimën e tij: “Më fal, poezi, nëse është faj që nxora/ këtë zë dhimbjeje”.

(Ese e shkurtër mbi Migel de Servantes [Miguel de Cervantes Saavedra, Alcalá de Henares, 5, 29 shtator 1557 - Madrid, 22 prill 1616: ushtar, romancier, poet dhe dramaturg spanjoll] dhe *Don Kishoti e Mançës*.)

VICTOR AQUILES JIMÉNEZ

Një qasje e re

Të vetmet qenie reale janë ato që nuk kanë ekzistuar kurrë.
Oskar Wilde

Çmenduria në letërsi; natyra njerëzore; një libër universal pa datë skadimi; një kritikë metaforike për botën; *Donkishoti*, një vepër e pamundur për t'u tejkaluar; hapësira të tjera përtej Tokës; “donkishot, donkishotesk” epitete fyese; kritikë e përparuar për kohën e vet; analizë psikiatrike, psikologjike; mijëra ese mbi një personazh fiksioni dhe një biografi e shkurtër mbi autorin e tij; ta nisësh të shkruarit nga çdo fjalë apo fakt i rëndomtë; dukuria metafizike e përcjelljes shpirtërore të autorit me personazhet e tij; analizë e personalitetit të Migel de Servantesit, pak neuroshkencë në fikson.

Kur mendoj për një vepër simbol në gjuhën time të nënës, spanjisht, pa kujtuar asnjë libër tjetër, ndonëse ka të tillë shumë cilësorë dhe të mrekullueshëm, menjëherë dhe vetvetëshëm, për nga përsosmëria e tij, më vjen në mendje *Donkishoti i Mançës*, i të papërsëritshmit dhe të paarrtshmit Migel de Servantes Savedra. Midis të tjerëve, më shfaqen në imagjinatë figurat mbizotëruese të Donkishotit, Sanço Panços, Rosinantit dhe Dulqinjës. Pra, të gjithë personazhe klasikë, të cilët i kemi lexuar për kënaqësi, për detyrim shkollor apo për kulturë të përgjithshme dhe pas të cilëve jemi dashuruar. Ndonëse është e vërtetë që Migel de Servantes shkroi shumë vepra të suksesshme dhe pati porosi e kërkesa, me *Donkishotin e Mançës* arriti përmasa universale. Shpesh jam rropatur të di për Migel de Servantes Savedrën, se si i lindi ideja, si e mendoi dhe si e skicoi kryeveprën e tij, duke dëshiruar, si çdo autor tjetër, që të shkruante një histori origjinale, me vlera universale, me një temë që të ishte e kuptueshme në çdo gjuhë dhe kulturë. Kishte zjarrin dhe talentin e mjaftueshëm për të shkruar një vepër gjeniale, nisur nga vetë asgjëja, por i mungonte vetëm tema, derisa e gjeti atë, të paraqitur në diçka aq të thjeshtë sa vetë çmenduria. Në të gjitha anët dhe në të gjitha kohët ka të çmendur, ashtu si dhe në të gjitha shtresat shoqërore, qofshin të pasur apo të varfër. Çmenduria te njerëzit është një e keqe e përveçme dhe e përgjithshme, e kemi midis nesh, pranë apo larg, që kur lindim e derisa vdesim. Aq e rëndomtë është çmenduria, saqë duket se askush nuk shpëton dot prej saj, sepse në ndonjë çast të jetës ajo mund të shfaqet me ndonjë patologji, me çrregullim personaliteti, nga depresioni, ndryshimi i humorit, nga goditjet dhe ndeshtrashat e jetës. Ajo ndeshet në organizimet dhe sistemet shoqërore, që nga këndvështrimet kulturore, politike, ushtarake, fetare e shkencore, prandaj mund të themi se jetojmë në një mjedis çmendurie. Kështu pra, nisur nga kjo premisë, sfida e Migel de Servantes Savedra ishte të gjente klisenë letrare, *leit motiv*-in dhe prototipin e personazheve që ngërthehen brenda imagjinatës së të gjithëve, që na përfaqëson të gjithëve, ngado ku ka njerëz, dhe s'kishte gjë më të mirë dhe më të volitshme për këtë, sesa një i çmendur i këndshëm; një plak i marrë, lexues novelash kalorësiake, të cilit, verbuar nga ato histori të largëta të së shkuarës, i shkon ndërmend t'i rikrijojë bëmat e atyre heronjve dhe legjendave, qartësisht, duke i vënë në jetë vetë. Në kohën e Migel de Servantesit, nuk ekzistonin profesione të tilla si, Psikiatria, Psikologjia a Sociologjia - njohuri dhe funksione shkencore për të dalluar, klasifikuar dhe diagnostikuar çmendurinë. Kështu që letërsia ishte

vegla më e mirë për t'i dhënë formë psiqikës së personazheve dhe për të zbërthyer marrëdhëniet e tyre në rrjetën shoqërore ku ata jetojnë dhe ku pështjellohen me kaq përsosmëri - prandaj, askush s'mundej dhe s'mund t'i përdorë qyshkaherë, me aq mjeshtëri, ato funksione, në mënyrë të natyrshme, më mirë sesa shkrimtari, kur bën përshkrimet psikologjike dhe rrethanore të personazheve të tij, mënyrën se si ata jetojnë, marrëdhëniet e tyre me shoqërinë, konfliktet dhe dyzimet kulturore. Të gjithë ne që e kemi lexuar *Donkishotin e Mançës*, apo kemi parë filmat, shfaqjet teatrale, apo kemi lexuar qindra artikuj dhe analiza për personalitetin e Donkishotit, e dimë se ishte një i çmendur, por, në këtë rast, një i çmendur i arsyeshëm, nga ata që shpesh i ndeshim në ndonjë vend pranë nesh. Donkishoti ishte i këndshëm, i zgjuar për nga padjallëzia dhe për nga dituria që rridhte brenda një padjallëzie gënjeshe, duke qenë se gjendja e tij patologjike ndoshta ishte produkt i një çmendurie pleqërie. Sidoqoftë, ajo çmenduri gjeniale na mbërthen. Migel de Servantesi kishte një njohuri të thellë për psikologjinë njerëzore, një dhunti të lindur, të zgjeruar dhe të shtjelluar nga leximi i veprave klasike dhe atyre të epokës së tij, gjithashtu edhe nga vetë të shkruarit, gjë që e bënte të ishte një njohës i përsosur i njeriut dhe shoqërisë. Ideja për të krijuar Donkishotin, e bëri të ngjizte një prototip universal, atë të njeriut të mirë, të heroit të padjallëzuar, altruist, rregull-thyes, revolucionar, të gatshëm për të luftuar të keqen dhe për të ndrequr botën. Servantesi e dinte se njeriu apo, më mirë njerëzit, nuk e ndryshojnë natyrën e tyre sot për nesër dhe se, duke përfytyruar dhe duke i dhënë jetë një personazhi aq të rëndomtë si Donkishoti, i ngërthyer nga një ideal, siç qenë kalorësit fisnik bredharak apo të kryqëzatave - model i vjetruar dhe në zhdukje në epokën e tij, - me cilësitë e zakonshme të çdo njeriu, që beson në gjëra të pamundshme dhe lufton për to, do ta tejkalonte kohën, sepse njeriu nuk ka për të ndryshuar, meqenëse vetë esenca e tij është të jetë i tillë. Ai diti ta

pajisë me një karakter të zakonshëm një personazh, i cili do të ishte prototipi botëror i njeriut ëndërrues dhe naiv, këtu në Evropë, në dy Amerikat, Azi, Kinë, etj. Dhe ky është një nga elementet e suksesit të veprës, aftësia për të përfaqësuar, me mish dhe me frymë, shpirtin e njeriut universal. Është e çuditshme dhe njëherazi e rëndësishme, të kuptosh vlerën e veprës së Servantesit me *Donkishotin*, i cili është libri i tij më i njohur. Servantesi, për nga aftësia, talenti dhe njohuritë e psikologjisë njerëzore, u ngrit përmbi gjithë gjenitë e letërsisë botërore të të gjitha kohërave, kur solli në jetë *Donkishotin*, i cili, shekuj më vonë, është studiuar nga ekspertë dhe shekullarë të sjelljes njerëzore. Për sa u përket feve botërore dhe perëndive të tyre, vlen të thuhet se Donkishoti është qenia e përsosur mitike, një lloj Jezusi, por që i përket letërsisë fiktive. Dhe prandaj, për shkak të karakterit universal të një plaku të marrë që niset për të ndrequr botën - diçka që duam ta bëjmë të gjithë, secili ashtu si mundet, - Donkishoti është bërë pjesë e shoqërisë, dhe kjo falë gjenialitetit të Servantesit, i cili diti ta zbërthejë natyrën njerëzore dhe ta përshkruajë në një mënyrë, që na bënë të gjithëve të ndihemi të identifikuar. Ky gjenialitet ia ka prerë krahët plejadës së shkrimtarëve në botë, të cilët, edhe pse kanë krijuar vepra të shquara, të jashtëzakonshme, gjeniale, nuk kanë arritur ta tejkalojnë dhe as do arrijnë ta tejkalojnë dot psikologjinë e Donkishotit, sepse Servantesi përparoi në kohë, ja sa e thjeshtë. Servantesi e përshkroi esencën njerëzore ashtu siç është tek një i moshuar i ngathët, i dobët dhe i shastisur, i tejngopur nga historitë, epopetë që donte t'i jetonte vetë në luftë për t'u bërë ballë vështirësive dhe për të mbrojtur më të dobëtit. Cili njeri altruist nuk e dëshiron apo nuk e ndien ndonjëherë këtë, që të dalë në mbrojtje të dikujt që ka nevojë? Prandaj, e shoh shumë të vështirë që ndonjë shkrimtar tjetër, sado gjeni që të jetë, të jetë i aftë për të krijuar një vepër që ta tejkalojë *Donkishotin* e Servantesit, gjë që e them me shumë respekt, duke përfshirë këtu edhe veten time, sepse Servantesi e arriti këtë, këtu e pesëqind vjet më parë. Është e mundur të sjellësh risi, të rikrijosh, të kopjosh modelin e Donkishotit, por ama ta barazosh është gati e pamundur, vetëm në rast se ne njerëzit nisim pushtimin e hapësirës dhe botëve të tjera dhe njerëzit e rinj të fitojnë zakone të tjera, përvoja të tjera, të krijojnë kultura të tjera dhe mendësi të ndryshme nga këto të njeriut të sotshëm në Tokë, dhe në një mjedis të ndryshëm, nëse do të jetë jetë i mundur ndonjëherë, gjeni të fjalës të nisin të shkruajnë historinë e asaj bëme dhe pas shumë kohësh të ketë prototipa të asaj kulture jashtëtokësore që t'i japin identitetin atyre njerëzve për të shkruar vepra gjeniale mbi ta. Servantesi e bëri këtë me *Donkishotin*, këtu në planetin tonë dhe në spanjisht dhe ky është një motiv tjetër për t'u ndierë krenarë. Historitë e librit *Donkishoti i Mançës*, janë të zhdërvjellëta dhe të thjeshta, vërshon talenti, përmbledhja e fjalëve, proza poetike, zgjuarsia dhe shkëndija nëpër tekste që na mbërthejnë qysh në zanafillë. Në epokën e Servantesit, teatri ishte shumë popullor dhe atje e fitoi përvojën e krijimit të dialogëve të shkëlqyer si autor i veprave teatrale, duke pasur si kundërshtar Lope de Vegën.

Servantesi, me veprën e tij tejet universale, *Donkishoti i Mançës*, i dha një ndihmesë vetë njeriut, duke përshkruar psikologjinë tonë më shpirtmadhe, si ajo e vënies së vetes në shërbim të kauzave të pamundura, siç bëri përballë mullinjve të erës, që përfaqësonin progresin, zhvillimin dhe teknologjinë, ndërsa era, vrullin dhe dinamizmin e pandalshëm të shoqërisë në zhvillim. Është një paraqitje e jashtëzakonshme metaforike e botës që po modernizohet, së cilës Donkishoti, në bashkëpunim me autorin e tij, Servantesin, i kundërvihet, për shkak se po zhduken kalorësit dhe legjendat e tyre.

Sot e kësaj dite, “donkishot” dhe “donkishotesk” janë epitete gati fyese, të këndshme, por lënduese. Të duash të luftosh për një botë më të mirë, kundër forcave aq të mëdha, si politikat e kapitalizmit në treva të ndryshme, në mbështetje të fushatave ekologjike në mbrojtje të Tokës, të luftosh kundër industrisë së pangopshme të produkteve me data skadimi, të luftërave fetare, të një terrorizmi të pakuptueshëm, të një shfrytëzimi dhe një pabarazie në shpërndarjen e të mirave materiale, të edukimit që na mëson për të punuar, por nuk na edukon për paqe dhe as për humanizëm, të epidemisë së korrupsionit, etj. Nëse do të donim t'i luftonim të gjitha





Don Kishoti, nga Salvador Dali

këto, që nga një pikëpamje letrare, dhe shumë të tjera që mbeten pa thënë, do të na duhej “të krijojmë” një histori si ajo e Donkishotit, që të ishte gazmore dhe njëherazi të kritikonte antivlerat e shoqërisë moderne, pa bërë armiq të pushtetshëm, ama nga pikëpamja letrare e fiksionit nuk ia vlen më ta tentosh diçka të tillë, sepse Servantesi ka katër shekuj që e ka bërë dhe ky është kontributi i tij, duke paraprirë kështu gjithë shkrimtarët universalë, dhe nuk është gjë e pakët ta dish dhe t’ia njohësh këtë privilegj. Pikërisht këtu qëndron rëndësia dhe merita e tij.

Të tërheqin vëmendjen studimet e shumta që profesionistët e shëndetit mendor dhe të sjelljes njerëzore kanë bërë mbi një personazh fiksioni si Donkishoti i Mançës, madje janë shkruar teza doktoraturash mbi këtë personazh të famshëm letrar, i cili mund të japë male të tëra me letra, duke e tejkaluar autorin, apo duke e lënë atë në plan të dytë. Mbi këtë veçori, don Migel de Servantes Savedra ka një biografi të shkurtër (duke pasur një jetë plot aventura dhe rreziqe, të pabesueshme, si ushtar dhe aventurier) që e njohim të gjithë: ka qenë në luftë, ka qenë i burgosur pesë vjet në Algjer; në luftën e Lepantos ka humbur dorën e majtë nga një e shtëne pushkëtopi; ka qenë taksambledhës, ku pati probleme si i tillë, dhe këto janë ato që duhet t’i dimë për të, për kulturë të përgjithshme, megjithëse ka studime dhe ese për jetën e tij shumë më të bollshme, që nga lindja deri në vdekjen e tij, por këto nuk janë asnjëherë aq të gjera dhe as i kapërcejnë studimet dhe esetë për “krijesën” e tij më të dashur apo për personazhet e tjera të veprës së tij. Na është thënë se Migel de Servantesi nuk arriti ta gëzojë suksesin e veprës së tij dhe se nuk fitoi para me të, se ishte i varfër dhe se kishte vështirësi ekonomike, por ka ca kohë, jo shumë, që u zbulua se paskësh qenë inspektor taksash, që do të thotë të ardhura të mira, të cilat i dhanë mundësinë për të krijuar një familje dhe për të shkruar. Po të kishte lindur në këtë epokë, do të kishte qenë shumë i pasur. Dimë se Donkishoti i Mançës, duke qenë një personazh letrar fiksioni, përkundrazi, profesionistët më të mirë të botës së sjelljes dhe sëmundjeve mendore, vlen të thuhet psikologët, psikiatrit, neurologët, filozofët, etj., kanë bërë secili studime dhe analiza të personalitetit dhe shëndetit të tij mendor, duke e marrë si referencë. Dyshoj të kenë bërë të njëjtën gjë me autorin e tij, sepse duke qenë real dhe duke pasur një jetë të vrullshme, sa aventureske aq edhe të rrezikuar, ishte “normale” të mungonte interesi shkencor për t’u thelluar më shumë në mendjen dhe sjelljen e tij. Sot për sot, që nga pikëpamja antropologjike dhe mjekësore, nëse gjenden eshtrat e tij, do të ishte vërtet emocionuese t’i analizoje për të zbuluar misteret që mund të tregonte ADN-ja e tij, ndoshta do të tregonin farefisninë e tij me Donkishotin.


Do të doja të flisja për diçka më metafizike, magjike apo të panjohur. E sjell shpesh në mendje çështjen, se kur, si dhe në ç’moment, i lindi Migel de Servantesit ideja për të shkruar kryeveprën e tij, duke menduar për veten, për të kënaqur egon e tij, duke njohur më së miri aftësinë narrative dhe talentin e tij, për të rrëfyer me çfarëdo fjale, ideje, ngjarje reale apo të sajuar në mënyrë interesante dhe emocionuese. A mendoi për këtë veper kur ishte tërë ato vite i mbyllur në burg, ku ndoshta mundi të lexonte shumë libra kalorësie ashtu siç do të bënte Donkishoti në librin e tij? A i erdhi në kokë ideja që të niste e të shkruante librin e tij kur bridhte nëpër qytet duke mbledhur taksat për Kurorën Mbretërore, duke biseduar nëpër taverna, duke këqyrur, duke dëgjuar rrugëve krijimet popullore të poetëve endacakë, këngët dhe historitë e trubadurëve? Në ndonjë çast i lindi ideja që të qeshte pak me botën, duke e satirizuar përmes një personazhi të aftë për t’u përballur me simbolet e asokohe, me anë të një veprë të rrezikuar, të interpretuar nga një i çmendur dhe të çmendurve u falet gjithçka, akoma më shumë nëse është edhe plak (asokohe, 50 vjeçar ishte plak). Migel de Servantesi mori “modele” ekzistuese të burrave dhe grave reale, të cilët shfaqen në veprën e tij. I kishte “të gdhendur” në mendje, sepse ishin pjesë e jetës së tij dhe thjesht përshkroi karakteristikat dhe morfologjitë e secilit prej tyre në veprën e tij të shquar, asgjë më tepër. Mund të kenë qenë personazhe që i ka parë nëpër rrugët e qytetit, kur qe taksambledhës, tipa të shkathët dhe të rëndomtë si Sanço Panço, për shembull, dhe gra që i frymëzuan Dulqinjën, gra të tilla që vetë ai mund të binte në dashuri me to teksa kalonte dhe i këqyrte, duke i dëshiruar të largëta dhe të pamundshme. Kjo është shumë e zakonitë në mendjen e një shkrimtari, i cili merr prej njerëzve që e rrethojnë apo që i sheh rastësisht, disa karakteristika, të cilat ua veshin personazheve të tyre letrare. Kjo është e thjeshtë për t’u kuptuar. Atëherë, fenomeni metafizik i ndërthurjes shpirtërore të autorit me personazhet e tij, më bën të pyes veten, në ç’moment Migel de Servantesi është Donkishoti dhe anasjelltas? Sigurisht, pyetja iu drejtohet më shumë shkrimtarëve sesa profesionistëve dhe ekspertëve të tjerë, të cilët janë profanë në dukurinë e artit narrativ. A është Servantesi, njëherazi Donkishoti dhe Sançoja? Unë besoj se po, se është një idealizim pak i grivët i vetvetes, që shkarkon dëshirat e zjarra, zhgënjimet dhe rebelimet e tij, me anë të dy personazheve, njëri, Donkishoti, i padjallëzuar dhe i mirë, dhe tjetri, Sanço Pançoja, qerrata dhe finok, përfaqësim i lartësuar i së keqes. Dhe që të dy duken protagonistë të hemisferave të ndryshme të të njëjtit tru. Donkishoti është ana e idealizuar e autorit, që mësyhet kundër botës në kërkim të së mirës, të vendosjes së drejtësisë, rregullit, respektit dhe fisnikërisë, dhe

Sanço Pançoja, shqytari i tij besnik, është ndërgjegjja e tij, nënvetëdija, frenat, instinkti i mbijetesës dhe bota. Me pak fjalë, Migel de Servantesi është njëherazi dy personazhet, prandaj ata janë aq dinak dhe të zgjuar dhe plotësues të njeri-tjetrit, njëri plotëson mangësinë e tjetrit.

Është shumë e vështirë të shpjegohet procesi i trurit dhe neuroneve të një gjenie, nga një amator i neuroshkencës si puna ime. Mendoj se deri tani, në këtë çast, nuk ka shkencë që mund ta bëjë këtë, me gjithë përparimin që ekziston sot. Sot është e mundur që, me anë të tomografisë, skanimit të trurit, të këqyret se si aktivizohen pjesët që kontrollojnë imagjinatën dhe të folurit, por nuk ka mënyrë të shihet se si lindin idetë, në mënyrë të përsosur, në trurin e një gjenie. Tek kinemaja, të themi filmi apo celuloidi, kur shohim në dritë, thjesht me sy, fotogramet, mund të krijojmë një ide se si është një plan, një skenë sekondash apo një sekuençë, duke numëruar me durim një nga një fotogramet, që kanë mbetur të regjistruar nga një proces kimik. Brenda trurit gjithçka ngelet e regjistruar tek neuronet dhe kombinimet e mrekullueshme sinaptike që realizon kujtesa, por ende nuk ka një aparat që të riprodhojë në kohë reale atë që mendon një njeri dhe jo më, nëse ai është një gjeni. Më e përafërta e kësaj që parashtrova është se kujtesa njerëzore vazhdon të jetë shumë e ndryshme nga kujtesa e një kompjuteri, i cili ruan dhe përpunon me algoritme të ndryshme në një mënyrë shumë të thjeshtë krahasuar me trurin njerëzor të një gjenie që gjendet në kulmin e procesit të të shkruarit. Truri i një shkrimtari me përvojë, ka mundësi të ketë «tabela» me algoritme natyrore, të cilat lidhen mes tyre në një sinaps neuronal të jashtëzakonshëm, duke prodhuar të krijuarit, origjinalitetin, thellësinë filozofike, metafizike, reale dhe abstrakte, në mënyrë të logjikshme, me intrigë dhe emocion, që tremb edhe vetë shkrimtarin, i cili gjithashtu befasohet nga mënyra e tij e të shkruarit dhe i gëlojnë fjalët. Për sa i përket kësaj, pa pasur ndonjë interesim për shahun, marr guximin të them se tani intelijenca artificiale e mund një kampion botëror në një lojë shahu. Pasi jam në dijeni se kjo është një lojë strategjie, logjike, por letërsia ka të tjerë parametra më të ndërlikuar, ku intuita luan një rol mjaft të rëndësishëm. A do të mundet intelijenca artificiale të shkruajë me gjenialitetin e Migel de Servantesit, një veper të barabartë apo më të mirë sesa *Donkishoti i Mançës*? A do të mundet një makinë e gjeneratës së fundit të inteligjencës artificiale (sibernetike) e programuar me algoritme më të përparuara, të shkruante një veper gjeniale, si *Donkishoti i Mançës*, duke nisur vetveti, në mënyrë çastësore, ndoshta e papërqendruar, ashtu siç mund të ketë qenë Migel de Servantes Savedra kur nisi të shkruante nga asgjëja, pa një ide të qartë në kokë, një hyrje të turbullt le të themi, me një penë të bojatisur në dorën e ngritur mbi letër: «Në një fshat të Mançës që s’dua t’ia kujtoj emrin, rronte pak kohë më parë një sojli nga ata me *shtijëzë* në sallën e armëve, me mburojë të vjetër, me kalë thatanik e me lingua të gjahut. Të tri çerekët e iratit të tij i harxhonte për ushqim, mish të zier prej lope më tepër se prej deleje ndonjëherë, pastërma me hudhra pothuaj për mbrëma, korminë të shtunave, *thier* të *premtëve* dhe *rrallë* e tek ndonjë pëllumb të dielave. Restat i harxhonte për veshjen, një dolloma prej cohe, tirq prej velludhi për ditët e shënuara, me pantofla prej gjithasaj stoffe, dhe për ditët e tjera të javës tesha prej shajaku nga më i miri. Mbante në shtëpi një kujdestare, që kishte kapërcyer të dyzetat, dhe një mbesë, që s’kishte arritur të njëzetat, dhe një shërbëtor për arën e për pazarin, që dinte t’i vinte shalën kalit dhe të përdorte kosoren. Sojliu ynë ishte nja pesëdhjetë vjeç; ish i fortë nga shëndeti, i thatë nga trupi, i mprehtë nga fytyra, ngrihej që menatë dhe ish merakli pas gjahut...»¹ Dhe fjalët gëluan njëra pas tjetrës, gjer sa e mbërthyen vëmendjen e Migel de Servantesit, i cili, pa e ditur, po shkruante në atë çast një nga veprat më të mrekullueshme të botës për të gjithë ne, lexuesit më të ndryshëm dhe shkrimtarët ëndërrimtarë që duam të ndryshojmë apo të përmirësojmë botën, pasi shumë shpirtra presin që ne t’u tregojmë rrugën ashtu siç bëri Donkishoti i Mançës... Dhe fatmirësisht e kemi njëherë e përgjithmonë Donkishotin e Mançës.

*Përkthyer nga origjinali spanjisht
ERION KARABOLLI dhe BAJRAM KARABOLLI*

1 Marrë nga përkthimi i F. Nolit. (Shënim i përkthyesit).



Në kohën e Homerit, njerëzit nuk e dallonin ngjyrën blu

nga Alex Bellos

A është e vërtetë që grekët e lashtë nuk i perceptonin të gjitha ngjyrat?

Kjo rrëfenjë fillon me një udhëheqës anglez liberal dhe hulumtimin e tij risues të ngjyrës blu. S'bëhet fjalë për Nick Clegg-un dhe Torët, por për William Gladstone dhe shqetësimin e tij për përdorimin e ngjyrës prej Homerit tek *Iliada* dhe *Odisea*. Gladstone ishte intelektuali i parë i shquar që vuri re diçka të çuditshme me perceptimin e ngjyrës prej poetit grek. Homeri nuk e përshkroi kurrë qiellin si "blu". Në të vërtetë, Homeri rrallë i përdorte fjalët që përcaktojnë ngjyrat dhe kur e bëri ato ishin thjesht të çuditshme. Deti ishte "i manushaqtë". Qetë ishin gjithashtu "të manushaqtë". Kurse, për Gladstone-in, deti dhe qetë nuk mund të kishin kurrsesi të njëjtën ngjyrë. Shpjegimi i tij ishte që grekët e lashtë nuk kishin zhvilluar aftësinë e perceptimit të ngjyrave, dhe kështu e shihnin botën bardh e zi vetëm me një vizë lidhëse të kuqe.

Interesi prej studiuesi i Guy Deutscher-t për syrin Homerik nuk përqendrohet tek zhvillimi apo optika por tek gjuhësia. A mund ta shohim diçka për të cilën s'kemi fjalë për ta përshkruar? Po. Grekët ishin në gjendje të dallonin nuancat e blusë po aq mirë sa ne mundemi tani, pavarësisht se mungonte një fjalor i veçantë për to. Megjithatë,

shkruan studiuesi Deutscher, edhe pse Gladstone e kishte gabim në lidhje me aftësinë e perceptimit të ngjyrave që kishin grekët, gjurmimi i tij për shfaqjen e fjalëve që përcaktonin ngjyrat ishte: "aq i mprehtë dhe largpamës sa shumica e asaj që shkroi ... vështirë se mund të tejkalohet sot.

Doli se nuk ishin vetëm grekët e lashtë që nuk thanë kurrë se qielli ishte blu. Asnjëra nga gjuhët e lashta nuk kishte një fjalë të duhur për ngjyrën blu. Ajo që ne tani e quajmë "blu" një herë e një kohë ishte pejsë e fjalëve të vjetra për të zezën ose për jeshilen. (Në fakt, kjo është arsyeja pse në Japoni dritat jeshile janë në të vërtetë një nuancë më e butë e jeshiles sesa në pjesën tjetër të botës. Fjala e përdorur për jeshilen e semaforëve është *ao*, që dikur kishte kuptimin e "jeshiles dhe blusë" por tani do të thotë blu. Në vend që të ndryshonin fjalën, ata ndryshuan ngjyrën.)

Deutscher argëtohet shumë duke e lidhur zbulimin e fjalëve që përcaktojnë ngjyrat me shfaqjen e tyre në të gjitha gjuhët sipas një rendi të parashikueshëm. E zeza dhe e bardha përdoren së pari si fjalë, pastaj e kuqja, pastaj e verdha, pastaj jeshilja dhe në fund bluja. (Megjithëse ndonjëherë jeshilja del para së verdhës.) E kuqja është shfaqur ndoshta e para sepse është ngjyra e gjakut dhe është nga ngjyrat më të lehta për t'u dalluar.

Jeshilja dhe e verdha janë ngjyrat e bimësisë. Dhe bluja është e fundit sepse, me përjashtim të qiellit, pak gjëra të natyrshme janë blu dhe boja blu është më e vështira për t'u bërë.

Deutscher-it i duhet gjysma e librit për të treguar historinë e ngjyrës blu, dhe megjithëse e shkruar në mënyrë magjepsëse dhe bukur, diskutimi përbën shmangie nga ajo që ai vërtetë do të shtjelloj, fakti që gjuha mund të ndikojë në mënyrën se si e perceptojmë botën. A është e mundur që dy njerëz të mendojnë ndryshe për botën thjesht nga ndikimi që ka gjuha që ata flasin? Deutscher-i beson se po, dhe jep tre shembuj: Guugu Yimithirr është gjuhë vendase australiane e cila na ka dhënë fjalën "kangur" por kjo gjuhë nuk ka fjalë për "majtas" dhe "djathtas". Në vend të kësaj, të gjitha drejtimet jepen sipas vendndodhjes së folësit në lidhje me pikat e horizontit që tregojnë busulla. Eksperimentet kanë treguar se folësit e Guugu Yimithirr-it kanë "intonacion të përsosur për të treguar drejtimin", pavarësisht nga kushtet e shikimit, nëse rrinë në vend apo janë në lëvizje, ata e dinë se nga është veriu. Ky është shembulli më i mrekullueshëm, thotë Deutscher, se si shprehitë e të folurit mund të kenë pasoja që shkojnë përtej të folurit, pasi ato ndikojnë në aftësitë e orientimit dhe madje edhe modelet e kujtesës.

HOMERI



ILIADA

Onufri

Së dyti, ai argumenton se sistemet gjinore mund “të ushtrojnë ndikim të fuqishëm në shoqërizimet mendore të folësve”. Folësve spanjollë dhe gjermanë iu kërkua të mësojnë përmendësh, në anglisht, emrat e njëzetë e katër objekteve duke e shoqëruar emrin e një personi me atë objekt.

Rezultatet treguan se e kujtonin më shumë objektin kur emri përputhej me gjininë e fjalës në gjuhën e tyre amtare. Kështu, një spanjoll e kishte më të lehtë të kujtonte një mollë nëse quhej Patricia (*la manzana* është gjinia femërore), dhe një gjerman nëse molla quhej Patrick (*der Apfel* është gjinia mashkullore). Shembulli i tretë është me ngjyrën blu. Rusishtja ka një fjalë për blu e çelur - *goluboy* - dhe një fjalë për blu të errët - *siniy*. Në disa teste folësit rusë ishin më të shpejtë në dallimin e disa nuancave blu sesa folësit anglezë. Përfundimi i Deutscher-it është se “në fund të fundit, folësit e gjuhëve të ndryshme mund t’i perceptojnë ngjyrat pak më ndryshe”.

Nga këto tre shembuj, vetëm i pari dukej i rëndësishëm. Aftësia për të ditur se nga cili kah është veriu në çdo kohë, madje edhe në errësirë, është aftësi e jashtëzakonshme që gjen zbatime të dobishme. Dy shembujt e tjerë treguan, më së paku, se gjuha pak ka efekt në perceptim pasi eksperimentet dukeshin të stërholluara dhe rezultatet ishin jo domethënëse.

Në hyrjen e studimit, Deutscher-i shkruan se psikologë dhe gjuhëtarë shumë të respektuar mendojnë se ndikimi i gjuhës tonë amtare në mënyrën se si ne mendojmë është e papërfillshme, ose e parëndësishme. Libri i tij është përpjekje për të treguar se ata e kanë gabim. Por përveç gjuhës Guugu Yimithirr, stili i jetës së folësve të së cilës është kaq i ndryshëm nga i yni, gjithsesi, Deutscher-i nuk më ka bindur vërtet se gjuha ka shumë efekt në perceptim, të paktën jo në

HOMERI



ODISEJA

Onufri

ndonjë mënyrë të habitshme ose, siç mëton ai, “tronditëse”. Sidoqoftë, nga ky libër studimor mësova shumë gjëra interesante dhe fakti që është shkruar bukur e bëri leximin një përvojë të këndshme.

Përktheu: Granit Zela

Homer, nga Auguste Leloir, 1841



**Shkrimtarja e parë vërtet
e madhe e viteve 2000
- *New Yorker***

NJERËZ NORMALË

**SALLY
ROONEY**

